


92  
2618



SPIRO XHAI

**LEFTER  
TALO**

92  
2418

5

SPIRO XHAI

R

# LETTER TALO

(Shënime dhe kujtime nga jeta e një Heroi të popullit)

34815

52419

SHËNIME DHE KUJTIME  
NGA JETA E NËJË HEROI  
TË POPULLIT

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»



LEFTER TALO

## HAPAT E PARA NË JETË

Lefter Talon e kam parë për herë të parë një ditë pranvere të vitit 1933. Shumë vjet kanë kaluar qysh atëhere, por edhe sot e kam të gjallë parasysht atë djalosh me trup të lidhur, me shpatulla të gjera, me një fytyrë në ngjyrë gruri ku shkëlqenin dy sy plot gjallëri.

Lefteri lindi në vitin 1913 në një fshat të vogël të Vurgut në rrethin e Sarandës, që s'ka pasur as emër të veçantë. Agai që e kishte fshatin çiflik të tij i kishte vënë emrin e vet, Hadër Aga; gjer në ditët e para pas çlirimit të vendit ky fshat njihej me këtë emër. Sot fshati i rilindur dhe gjithë kooperativa e bashkuar ka marrë emrin e Lefterit.

Në ato vite kur lindi Lefteri, ky fshat i vogël nuk kishte më shumë se njëzet kasolle, të ngritura mbi një kodër të butë, prej nga mund të vështroje fushën e përmytur të Vurgut dhe fshatra të tjera të mjeruara përfaq. Nga kjo fushë pjellore punohej vetëm një rrip i ngushtë, kurse pjesa tjetër ishte kthyer në një kënetë të madhe, që përmendej vetëm për një gjë: për retë e mushkonjave, që dilnin nga ujërat e ndenjura për të përhapur në fshatrat përreth malarien, që këtu e quanin «ethet e Vurgut». Në kodrat e buta e në

plllajat e pjerrëta të malit të Milesë, mbi fshatin e vogël Hadëraga, shtriheshin kullota të bukura, ku dimëronin për vit mijëra dhen të stanarëve të pasur. Po këto kullota të pasura, që bleronin si në pranverë edhe në palcë të dimrit, ashtu si edhe fusha, ishin pronë e agallarëve të pamëshirshëm, që luftonin t'i zgjeronin çifliqet e tyre «gjer te streha e shtëpisë», siç thoshin fshatarët e Vurgut. Fshatarët e varfër nuk kishin asnjë pëllëmbë tokë për vete; ata edhe truallin e shtëpisë e merrnin me qira nga agallarët, të cilët mund t'i nxirrnin kur të donin nga kasollet e tyre të mjeruara. Kjo gjendje nuk ishte vetëm në fshatin ku lindi Lefteri, por në gjithë Vurgun, e pak a shumë në të gjithë Shqipërinë. Anëmbanë vendit fshatarët pa tokë lëngonin nën shtypjen e dyfishtë të çifligarëve të pamëshirshëm dhe të qeverive antipopullore të asaj kohe.

Si gjithë bashkëfshatarët e tjerë edhe njerëzit e familjes së Lefterit merreshin më bujqësi, me tokën. Nga fisi i madh i Talove kanë dalë gjithnjë bujq të mirë, që e punonin tokën me zell të madh dhe e vaditnin me djersën e tyre, por nuk shihnin kurrë një ditë të bardhë, sepse frytin e punës së tyre e përvetësonte agai. Duke jetuar në kondita të vështira disa njerëz nga fisi i tij kishin qenë të detyruar të merrnin rrugën e kurbetit të zi.

Në një ambient të tillë, ku bëhej fjalë vazhdimisht për skamje e për mjerim ku flitej me urrejtje të thellë për çifligarët gjakpirës dhe ku shpeshherë midis bujqve e zotërinjve shpërthenin përleshje të ashpra, që jo rrallë përfundonin edhe në gjakderdhje, e kaloi fëmininë Lefteri.

Lefteri ishte ende nxënës shkollë, kur në

fshatin fqinj Sopik plasi një konflikt i ashpër midis fshatarëve dhe agallarëve. Agallarët e pangopur donin t'ua merrnin fshatarëve edhe atë pak musha që u kishte mbetur për të kullotur ato pak dele që kishin. Atëhere gjithë fshati u ngrit në këmbë. Urrejtja shekullore që ziente në shpirtin e fshatarëve shpërtheu me një forcë të madhe. Në këtë përleshje morën pjesë aktive gratë, që i mbyllën agallarët në kullat e tyre dhe u vunë zjarr. Ja se si përshkruhet në historikun e Sarandës kjo revoltë masive e fshatarëve të Sopikut kundër agallarëve dhe forcave të xhandarmërisë së Zogut:

«Një nga ngjarjet që karakterizojnë rezistencën e fshatarëve të rrethit të Sarandës ndaj çifligarëve dhe ligjeve të regjimit të Zogut është edhe revolta e fshatarëve të Sopikut në lokalitetin e Livadhjasë gjatë viteve 1925-1927.

Pronarët e kullotave rreth fshatit Sopik Hajro Ciniu dhe Xhelo Shameti kishin vendosur të pushtonin me forcë mushatë e ta mbyllnin kështu fshatin si në kafaz. . . Grindja e parë midis pronarëve të tokave dhe banorëve të Sopikut filloi aty nga vjeshta e vitit 1925. Fshatarët hapën disa toka dhe me gjithë kundërshtimin nga ana e rojtarëve në vjeshtë të vitit 1926 i mbollën këto toka me grurë. Në nëntor agallarët lëshuan kopetë e dhenve për të prishur grurin e mbjellë. Atëhere gjithë fshati, burra e gra, u lëshuan dhe i nxorën kopetë e agallarëve jashtë tokave të mbjella me grurë. Mirëpo në qershor të vitit tjetër, kur erdhi koha e korrjeve, agallarët dërguan njerëzit e tyre për të marrë të tretën e prodhimit. Bile qehajai i agait u doli përpara në rrugë fshatarëve që çonin grurin në shtëpi, ua shkarkoi kafshët me zor. Atëhere u lë-

shuan gratë dhe e ndoqën qehajënë jashtë kufive të fshatit. Kjo i revoltoi shumë agallarët që kërkuan ndihmën e xhandarmërisë. Në një takim që u bë në qendër të fshatit agallarët kërkuan t'u njihej pronësia mbi tokat e reja që kishin hapur fshatarët. Banorët e Sopikut u kërkuan tapitë dhe agallarët duke u treguar Delvinën u thanë: «Kush guxon le të vijë t'i shikojë». Pas takimit, që nuk dha asnjë përfundim, xhandarët filluan nga arrestimet. Të arrestuarit i mblodhën në postë-komandë dhe i shtruan në dru për t'i detyruar të pranonin pronësinë e agallarëve mbi tokat e reja.

Fshatarët e arrestuar nuk pranuan të nënshkruanin dokumentin e pronësisë dhe filluan të bërtisnin me të madhe. Atëhere u mblodhën rreth postë-komandës gra e burra për të protestuar duke qëlluar me gurë dyert e dritaret e postës. Pastaj ashtu siç ishin të bashkuar u lëshuan kundër kullës dhe koçekëve të agait. «Ta vrasim aganë dhe t'i djegim kullën» — bërtisnin gratë dhe me hunj e kosore rrethuan kullën dhe i vunë zjarr. Agai, i trembur për vdekje, doli nga një vrimë dhe me ndihmën e një vegle të tij nga fshati, ua mbathi këmbëve drejt Vagalatit.

Pas kësaj ngjarjeje postë-komanda mori urdhër që t'i lëshonte të arrestuarit. Kur u qetësua pak gjendja, nënprefekti dërgoi forca të mëdha xhandarmërie. Këto forca arrestuan 74 burra dhe i çuan të lidhur në Konispol. Kundër tyre përdorën edhe shtrëngimin edhe mashtrimin që t'i detyronin të firmosnin një dokument ku të njihej pronësia e agallarëve mbi tokat e diskutueshme. Por të arrestuarit u treguan të fortë dhe nuk pranuan. Gjendja në fshat ishte alarmante. Fshatarët

e Sopikut ishin të revoltuar nga këto masa të egra të autoriteteve qeveritare, që u shërbenin verbërisht agallarëve. Për të mos shkaktuar trazira të tjera, që mund të përhapeshin edhe në fshatra të tjera të Vurgut, qeveria u detyrua të ndërronte rrethkomandantin e Konispolit dhe të lironte të arrestuarit. Kështu me një luftë këmbëngulëse, fshatarët e Sopikut i fituan tokat që kishin hapur vetë me duart e tyre».

Këto ngjarje tronditëse për atë krahinë lanë gjurmë të thella në shpirtin e Lefterit. Shumë vjet më vonë, aty nga mesi i vitit 1936, ai shënonte në ditarin e tij: «Unë atëhere isha i vogël dhe shumë gjëra nuk mund t'i kuptoja ashtu si duhet. Po qysh atë ditë nisa të kuptoja një gjë të madhe e të rëndësishme: se prapa agajt qëndronte qeveria, xhandari. Agai dhe xhandari ishin në të njëjtën anë të barrikadës. Në anën tjetër qëndronim ne fukarenjtë, populli»...

Duke u rritur në një ambient me përlleshje të vazhduarshme klasore, në shpirtin e djalit të vogël të Vurgut lindi ajo urrejtje e thellë kundër agallarëve — pronarëve të tokave, që i vuri vulën gjithë veprimtarisë së tij të mëvonshme...

Në fshatin e vogël e të varfër ku lindi Lefteri nuk kishte asokohe shkollë fillore. Bijtë dhe bijat e katundarëve mbeteshin në masë analfabetë. Familja e Lefterit nuk donte ta linte atë pa shkollë. Gjyshi i Lefterit, Panajot Talo, ishte njeri arësimesdashës dhe mendoi ta dërgonte të nipin në fshatin Dhrovjan, ku kishte prej kohe shkollë. I ati i Lef-



terit Miço Talo, lidhur me punën e shkollës së të birit, tregonte: «Edhe sikur të mos donim ne ta dërgonim në shkollë, ai e kishte vendosur të mësonte me çdo kusht. Dhe po t'i mbushej mendja atij për një gjë, nuk ja ktheje lehtë. Ndaj vendosëm ta dërgonim te një miku im në Dhrovjan për të mbaruar të paktën shkollën fillore».

Kështu Lefteri për hir të shkollës u detyrua të largohej nga familja që kur ishte tetë vjeç. Në Dhrovjan, që është disa orë larg fshatit të tij të lindjes, Lefteri qëndroi dy vjet, gjersa mbaroi klasën e parë e të dytë të fillores. Dy klasat e tjera i bëri në Leshnicën e Poshtme e në Delvinë.

Pasi mbaroi shkollën fillore, ai vazhdoi mësimet në shkollën e ulët të gjimnazit në Filat të Greqisë. Pesë vjet më vonë mbaroi Shkollën Normale të Janinës.

Gjatë kohës së studimeve në shkollën Normale Lefteri vuajti shumë nga ana ekonomike. Gjendja e familjes në fshat nga dita në ditë keqësohej dhe Lefteri rronte në një varfëri të madhe. Në një letër që i dërgonte familjes më 9 tetor 1930 i shkruante: «Kam mbetur pa asnjë kacidhe në xhep; jo vetëm kaq, por jam detyruar të marr hua nga disa nxënës të klasës. Po ata nuk janë bankierë, me xhepe të mbushura me pare, e m'i kërkojnë përditë borxhet... Si do të bëhet puna ime? Unë jam këtu më i varfëri se gjithë shokët e e mi të klasës... Të dashur prindër. Nuk kam aspak ndër mend që t'ju mërzis. Po kjo është gjendja ime...»

I ati i Lefterit në përgjegje të kësaj letre i shkruante: «... Ke hakë, or biri im, por ku t'i gjejmë ne paratë pa. Çfarë kemi për të shitur? Edhe po të

donim të shisnim ndonjë kokë bagëti nga ato të shtëpisë, kush ta merr? Ne këtu kemi varfëri me thes...»

Në Normalen ku studjonte Lefteri kishte grupe të rinjsh komunistë. Nga sa tregonte vetë ai, qëkur ishte në klasën e tretë të Normales, mori lidhje me elementët komunistë dhe u njoh në vija të përgjithshme me idetë komuniste. «Jeta, varfëria e skamja më jepnin të kuptoja se padrejtësia sundonte kudo. Po fajtorët për këtë gjendje dhe mjetet për ta ndryshuar atë s'mund t'i gjeja vetë. Atë që s'mund ta gjeja vetëm ma treguan idetë komuniste, që më hapën sytë dhe më ndriçuan rrugën e jetës» — shkruan ai në ditarin e tij kur ishte ende nxënës i Normales.

Në dy vjetët e fundit në shkollë ai zhvilloi një aktivitet revolucionar midis nxënësve të shkollës. Shokët e tij të shkollës kallëzojnë se ai kishte qenë në radhët e para të studentëve në të gjitha demostratat dhe aksionet e tjera konkrete të rinisë shkollore. Në ditarin e tij të asaj kohe shkruante: «Në demonstratën e parë mora pjesë spontaneisht, kur pashë shokët e klasave më të larta që luftonin për një çështje të drejtë. Atëhere ata që ishin në rininë komuniste m'u afruan dhe më hapën zemrën. Kështu fillova të njihem me të vërtetën e madhe të jetës...». Ky aktivitet ra në sy të njerëzve të drejtorisë e të spiunëve të qeverisë. Dhe qysh atëhere për atë fillojnë përjashitimet nga shkolla dhe ndjekje të tjera. Këto ndjekje e persekutime, në vend që ta trembin bëjnë efekt të kundërt tek ai. Ai e zgjeron edhe më shumë aktivitetin propagandistik në masën e rinisë shkollore. Qysh atëhere u duk Lefteri se do të bëhej njeri i aksionit, njeri i veprimtarisë praktike revolucionare.

## PERIUDHA E VEPRIMEVE SPONTANE DHE E ËNDËRRIMEVE

Në verë të vitit 1933 Lefteri mbaroi Shkollën Normale. Me diplomën e mësuesit në xhep, me një-violinë dhe me disa libra marksiste nisët menjëherë për t'u kthyer në fshatin e lindjes. Gjatë viteve të studimit ai ishte dalluar në mënyrë të veçantë në muzikë. Bile kishte marrë pjesë edhe në konkurse të violinës dhe dy herë kishte fituar edhe çmime. Pasioni i tij për muzikën në përgjithësi e për violinën në mënyrë të veçantë, ka qenë shumë i madh. Ai edhe më vonë, gjatë viteve të vështira të luftës, kur takonte fshatrave instrumentistë popullorë, ua merrte violinën dhe luante me mjeshhtëri. Dhe ata habiteshin kur shikonin atë partizan me pamje të ashpër, që dinte të luante jo vetëm në çarkun e pushkës, por edhe thuprën e violinës...

Kur u kthye nga shkolla, fshatin e tij të lindjes e gjeti në një gjendje më të mjeruar nga ç'e kishte lënë. Regjimi feudoborgjez i Zogut e mban-te vendin në një amulli të gjithanshme. Kriza e madhe ekonomike e viteve 30, që kishte tronditur gjithë botën kapitaliste, përhapte hijen e saj ogur-zezë edhe mbi ekonominë e dobët e të prapambe-tur të Shqipërisë së atëhershme. Fasada e jasht-me e botës kapitaliste, e zbukuruar me ngjyra të rreme, kishte pësuar plasaritje të mëdha dhe tani dukej më qartë kalbësia e një shoqërie të plakur e të dënuar nga historia me vdekje.

Në Vurg krahas shfrytëzimit të vjetër feudal, po merrte hov edhe një shfrytëzim tjetër më i

rrefinuar, shfrytëzimi kapitalist. Në atë kohë në fshatin Aliko të Vurgut kapitalisti italian Mimbeli bleu tokat e agallarëve dhe i ktheu në një plantacion të madh vreshtash e frutash. Po jeta e fshatarëve të Alikos e të fshatrave të tjera përreth, në vend që të përmirësohej, u keqësua më shumë. Fshatarët provuan në kurrizin e tyre se ç'ishte në realitet shfrytëzimi kapitalist dhe ç'rrjedhime të këqia po i sillte vendit penetrimi i kapitalit të huaj e në mënyrë të veçantë i kapitalit italian. Bujqit e Vurgut në bisedat e tyre thoshin: «Agallarët na qethnin për vit, kurse ky lord nga Evropa kërkon të na marrë edhe lëkurën; agallarët na pinin gjakun si shushunja, Mimbeli kërkon të na marrë edhe shpirtin».

Në një gjendje të tillë të vështirë fillon aktivitetin e tij si arësimtar Lefteri. Ai punoi si mësues në fshatin e vet, në Çukë të Sarandës dhe në Pepel të Dropullit të Sipërm. Ai që në fillim nuk u kufizua vetëm me punët e klasës e të shkollës. Por qysh në hapat e para të punës së tij vuri re se e luftonin me çdo mjet edhe agallarët, edhe autoritetet, edhe kleri. Në ditarin e tij ai shkruan: «Kur mbarova Normalen drejtorja na dha në dorë një copë letër dhe na tha: «Me këtë diplomë do të çelni rrugën e jetës. Rrugë të mbarë e suksese në punë!» Por prapa shpine ajo hartoi një dokument tjetër me këtë përmbajtje: «element i rrezikshëm e turbullues, i kuq». Dhe këtë dokument e përcolli para nesh, që ta gjenim kudo përpërpara si fantazmë. Kjo është shoqëri me dy faqe; nga njëra anë të shtrëngon dorën, kur të jep diplomën, e të uron rrugë të mbarë, nga ana tjetër kërkon që të të mbyllë me çdo kusht rrugën e jetës. . .

Tani s'na mbetet gjë tjetër veçse ta hapim atë rru-  
gë me gjoks, me luftë e po të jetë nevoja edhe me  
pushkë...»

Si mësues fshati Lefteri shfrytëzonte çdo rast  
për të zhvilluar aktivitetin e tij si brenda edhe  
jashtë shkollës. Në klasë ai pak gjëra mund të  
bënte me nxënësit. Të mos harrojmë e në atë kohë  
regjimi u kishte dhënë të drejtë xhandarëve injo-  
rantë të hynin në shkolla e të kontrollonin punën  
e mësuesve. Megjithatë ai gjente disa mënyra për  
të punuar me nxënësit.

Në ato vite nxënësit e shkollave fillore duhej  
të shkonin çdo të diel e festë fetare në kishë.  
Lefteri, për të prishur këtë rregull, organizonte  
të dielave shëtitje në natyrë, që t'i shkëpuste nxë-  
nësit nga ndikimi i kishës. Kjo ra menjëherë në  
sy dhe priftërinjtë filluan të trillonin lloj-lloj aku-  
zash kundër tij. Në ditarin e tij të asaj kohe ay  
shënon: «Gjer tani kisha gjetur belanë nga zyrtar-  
rët e qeverisë e nga xhandarët. Tani këtu në fshat  
m'u qepën priftërinjtë. S'ka gjë. Ata duan të shkoj  
në kishë e t'u puth dorën. Por unë s'e bëj dot  
këtë gjë. Le të bëjnë ç'të duan...»

Lefteri ka qenë ateist që kur ishte nxënës i  
shkollës së mesme. Pasi kishte vizituar një muze-  
um të shkencave të natyrës, kishte shënuar në një  
fletore: «9 gusht 933. Sot vajtëm në muzeumin  
e shkencave të natyrës. Është një mrekulli e vër-  
tetë. Po ç'e do? Muzeume të tilla ka vetëm nëpër  
qytete të mëdha, kurse duhet të kishte në çdo kra-  
hinë... Duke kaluar nëpër sallat e ndryshme të  
muzeumit pashë fare qartë origjinën e vërtetë të  
njeriut... Po të kishte institucione të tilla kudo  
edhe perëndisë do t'ja tregonim lehtë vendin...»

Është për të vënë në dukje përpjekja që bënte Lefteri si mësues për të rrënjosur në shpirtin e nxënësve dashurinë për punën dhe frymën e kolektivit. Në çdo fshat ku punoi si mësues, puna e tij e parë ishte krijimi i kopshtit shkollor. Atje së bashku me nxënësit bënte eksperimente të vogla në kultivimin e bimëve. Nga prodhimet e kopshtit krijonte një fond të vogël për të blerë libra e sende të tjera shkollore për nxënësit e varfër. Kur ishte mësues në Pepel të Dropullit të Sipërm ai kishte krijuar një fond të vogël dhe kishte blerë libra, pena lapsa e bojë për përdorim të përbashkët nga ana e nxënëve. Me këtë ai përpiquej që t'i edukonte nxënësit me ndjenjën e dashurisë për kolektivin. Në një fjalim që kishte mbajtur në këtë fshat me rastin e mbylljes të vitit shkollor, tridhjetë e ca vjet më parë, ai kishte thënë përpara prindërve dhe nxënësve edhe këto fjalë që ruhen në një fletore të vjetër shkolle: «Në jetën tonë duhet të vëmë në zbatim parimin: të punojmë më parë për interesin e përgjithshëm dhe pastaj për interesin vetiak... Kur kolektivi është i lumtur edhe individi, si pjesë përbërëse e kolektivit, do të jetë i lumtur, ndërsa po të jetë i lumtur individi nuk mund të themi që edhe kolektivi është i lumtur...» Pastaj, duke u drejtuar nga ana e nxënësve, u tha: «Përparimi i fshatit tuaj dhe i gjithë vendit varet nga ju, nga brezi i ri...»

Jorgo Bllani, ish-nxënës i Lefterit dhe partizan i vjetër gjatë Luftës nacionalçlirimtare tregon: «Ai çdo natë i binte violinës në dhomën e vet. Ne fëmijët, mblidheshim jashtë dritareve për të dëgjuar. Kur na shihte ai na fuste brenda në dhomë e na mësonte disa këngë, që nuk i kishim

dëgjuar ndonjëherë tjetër. Lefteri i kishte shumë qejf shëtitet e gjata bashkë me ne, nxënësit e tij! Në këto shetitje ai merrte me vete edhe violinën apo mandolinën. Dhe aty pranë krojeve të malit ai i binte violinës dhe këndonte vetë këngë revolucionare. Sa bukur i binte violinës Lefteri! E me ç'pasion i këndonte këto këngë, të cilat na i mësonte edhe neve. Nja dy herë na ka bërë edhe qitje me armë të gjuetisë. Ne edhe trembeshim edhe habiteshim. Por ai na thoshte: duhet të dini edhe përdorimin e pushkës...» Nga sa mbaj mend unë, nja dy-tri herë na ka mësuar këngë revolucionare edhe brenda në klasë. Dhe shkolla jonë e vogël jehonte nga melodia e fuqishme e këtyre këngëve... Pas disa vjetësh ne morëm vesh se mësuesi ynë kishte dalë partizan maleve të Shqipërisë për të luftuar kundër armikut. Më vonë dola edhe unë partizan, bashkë me një shok tjetër të klasës. Kur vajtëm në batalion, pyetëm për Lefterin. Partizanët na thanë se ai ndodhej në një repart tjetër, që ato ditë luftonte andej nga fshatrat e Këlcyrës. Kur mbërritëm në një fshat, partizanët e batalionit filluan të këndonin. Midis këngëve të tjera ja morëm edhe këngës së punëtorisë. Bashkë me ta këndonim edhe ne, që sapo kishim vajtur në batalion. Po të na pyeste njeri: «Ku e keni mësuar këtë këngë?» Do t'i përgjigjeshim: «Ne e kemi mësuar prej kohe në shkollën e fshatit. Na e ka mësuar mësuesi ynë, Lefter Talo...»

Duke punuar disa vjet me radhë si mësues fshati Lefteri i njohu më mirë jo vetëm hallet dhe vuajtjet e vegjëlisë, por edhe aspiratat e saj më të thella. Ata që e kanë njohur atë në atë periudhë theksojnë veçanërisht këtë: «Ai as edhe një

ditë nuk kufizohej vetëm me punët e shkollës, se e preokuponin problemet e popullit».


Mimi Zhapa, që e ka njohur nga afër në kohën kur ishte mësues në Vurg e në Dropull, thotë: «Lefteri nuk humbiste asnjë rast për të demaskuar regjimin e urryer të Zogut. Mbi të gjitha ai luftonte çdo padrejtësi që shihte, nga çdo anë që të vinte... Mbjaj mend një ditë kur ishim të dy në Jorgucat të Dropullit. Aty u takuam me një mësues tjetër. Lefteri hapi menjëherë bisedë. Mirëpo ai kishte pikëpamje reaksionare dhe u revoltua shumë kur dëgjoji Lefterin që lavdëronte komunizmin dhe Bashkimin Sovjetik. Dhe meqë i mungonin argumentat ju kanos Lefterit se do ta kallëzonte në inspektoriatin e arësimit. «Ku do të më kallëzosh? — e pyeti Lefteri me ironi, — në inspektoriatin e arësimit? Shko më mirë te mbreti, se ndoshta të jep edhe ndonjë dekoratë. Po sido që të bësh ti, idetë komuniste do të bëjnë për vete njerëzit e punës e më në fund do të triumfojnë...»

Aktiviteti propagandistik i Lefterit arriti edhe në vesh të qeverisë. Më 1935 arrestohet për herë të parë nga xhandarët e Zogut, por lirohet përsëri për mungesë provash. Autoritetet qeveritare ndjekin veprimtarinë e tij nga afër. Disa njerëz të tij, që e shikonin rrezikun e një arrestimi të ri, e këshilluan të shikonte punën e tij dhe asgjë tjetër. Por ai nuk tërhiqet dhe hidhet në aksione konkrete kundër agallarëve.

Tokat e fshatit të tij të lindjes u përkisnin disa familjeve agallarësh, ndërsa kullotat që shtriheshin rreth fshatit ishin pronë të pasanikut të madh Janaq Llapa, i cili rronte familjarisht në Janinë. Në një vend pranë fshatit ishte një tokë

L. U. J. A. E. S. H. I. E. D. I.  
K. S. T. E. J. 241 P  
34821





Lefteri së bashku me nxënësit e tij të fshatit Pepel-Dropull

pjellore, që quhej Fteri, e që fshatarët shumë kohë më parë e mbillnin me drithra buke. Por më vonë çifligarët e kishin kthyer në kullotë këtë tokë pjellore, se kështu fitonin më shumë. Lefteri në pranverë të vitit 1935 i bindi bashkëfshatarët që ta mbillnin së bashku këtë tokë pa marrë aprovimin e agait. Fshatarët e dëgjuan; një ditë të mirë u ngritën të gjithë dhe, duke punuar së bashku, bënë tokën ugar dhe e mbollën me duhan. Në këtë aksion ndihmuan edhe pleqtë. «Ka të drejtë Lefteri, — thoshin ata, — bashkimi bën fuqinë. Agai është një, kurse ne jemi një fshat i tërë».

Lajmi për këtë veprim të fshatarëve të Hadër Agait arriti edhe te njerëzit e qeverisë edhe te veshi i pronarit. Janaq Llapa u nis menjëherë nga Janina për të shikuar gjendjen në vend. Duke kaluar nga Delvina ai bisedoi me autoritetet lokale, mori me vete disa xhandarë dhe shkoi në fshat. Kur mbërriti aty pronari i kullotave e kuptoi menjëherë se organizatori i këtij veprimi ishte Lefteri. Po të izolonte Lefterin, do ta kishte më lehtë t'i bënte zap fshatarët. Ndaj filloi menjëherë me dinakëri; bëri një takim me pleqtë e fshatit dhe përgatiti terrenin me marifet. «Më vjen keq, — u tha, — që ju tërheq nga hunda një çunak pa mend në kokë...» Pastaj, duke u kthyer nga gjyshi i Lefterit, që merrte pjesë në këtë takim, i tha: «Dëgjo xha Panajot! Lefteri yt ka dalë nga rruga e perëndisë; ai është bashkuar me disa horra komunistë dhe punon për të na prishur fenë. Ndaj bën gjëra që janë në kundërshtim me vullnetin e zotit...» «Lefteri im punon për një çikë drejtësi, zoti Janaq, — ju përgjegj plaku i prekur në sedër. — Ai lufton që edhe fukarai të ketë një

copë tokë...» Mirëpo pleqtë e tjerë, kur dëgjuan fjalët e agait për punën e fesë, sikur u turbulluan pak dhe disa nga ata morën anën e pronarit të kullotave.

Kështu filloi e çara e parë në radhët e fshatarëve të Hadër Agait. Janaq Llapa, avokat nga zanati, ka qenë një dhelpër e vjetër në mashtrime e në dallavere të këtij lloji dhe kaloi menjëherë në sulm. Terrenin e kishte përgatitur me kujdes. Xhandarët dhe autoritetet e tjera të vendit ushtronin presion të hapët në masën e fshatarëve. Pas disa ditësh pronari i kullotave organizoi një mbledhje me kryepleqësinë e fshatrave përreth, që ta mbyllte atë plagë para se ajo të përhapej më shumë. Në këtë mbledhje ai donte të godiste në shenjë, të demaskonte Lefterin. Dhe në çastin e duhur ngriti zërin e tha: «Mos dëgjoni Lefter Talon! Ai është komunist, është ateist dhe përpiqet të na prishi fenë e të parëve tanë. Kush ndjek rrugën e Lefterit do ta ketë keq edhe me qeverinë edhe me perëndinë...»

Në atë mbledhje nuk u muarr ndonjë vendim konkret, por u pa qartë se fronti i bashkuar i fshatarëve qe thyer. Të nesërmen pronari i kullotave dërgoi njerëzit e tij që e shkulën duhanin e mbjellur. Fshatarët nuk guxuan t'u kundërshtonin. Pronari, që të mos përsëriteshin më akte të tilla, i paditi fshatarët e në radhë të parë Lefterin në gjyq. Lefteri edhe në gjyq foli me guxim dhe e demaskoi keq pronarin dinak. U duk se përpjekja e parë e Lefterit për t'u futur në përlëshje të hapur me çifligarët dështoi. Por nuk ishte ashtu. Bimët e duhanit vërtet u çrrënjosën nga toka dhe u thanë, por ky aksion la gjurmë të thella në shpirtin

e fshatarëve të varfër të të gjitha fshatrave për-reth...

Pas një kohe i ati i shkruante Lefterit që ndodhej në Tiranë se pronari i kullotave Janaq Llapa kishte vdekur. Dhe ai shënon në ditarin e tij: «Babai më shkruan nga fshati se pronari i kullotave të fshatit Janaq Llapa vdiq. Plaku mendon se unë do të gëzohem nga ky lajm. Po me mua ndodh e kundërta. Unë do të dëshiroja që ai të jetonte gjer në përleshjen vendimtare...»

Në atë kohë Lefterin e thirrën nën armë dhe meqë kishte arësim të mesmë, e caktuan në shkollën e plotësimit për oficerë. Kështu ndërpritet për një kohë puna e tij si mësues dhe aktiviteti i tij në fshatrat e Vurgut. Por ardhja e tij në Tiranë, largimi nga ambienti i ngushtë i fshatit të atëhershëm, njohja me shokë të rinj, s'ishte e mundur të mos ndikonin në mënyrë pozitive në formimin e tij si revolucionar. Megjithëse nuk kemi asnjë të dhënë që ai gjatë kohës së qëndrimit në Tiranë të ketë krijuar lidhje me ndonjë nga grupet komuniste, prapëseprapë kemi një sërë gjërash që tregojnë një pjekuri më të madhe e një thellim të mëtejshëm në problemet e mëdha të kohës. Shkrimet e tij më të mira në ditar, që e mbante gjithnjë me vete, i përkasin kësaj periudhe. Ai edhe më parë e kishte zakon të shkruante kohë mbas kohe mbi ngjarjet kryesore të jetës së tij dhe të ambientit ku jetonte. Por tani shkruan më shpesh dhe nuk merret më me çështje personale, por më tepër me ngjarjet më të rëndësishme të asaj kohe. Nga ana tjetër edhe kur shkruan për gjëra të rrethit të tij të ngushtë përpiqet të thellohet e të nxjerrë konkluzione të drejta

përgjithësonjëse. Mbi të gjitha ai ka besim në trimfin e ideve komuniste e në një të ardhme të shkëlqyer për popullin tonë. Për ta ilustruar këtë po japim vetëm disa citate nga ditari i tij:

Më datën 25.VII.1936, duke qenë nxënës në Shkollën e plotësimit në Tiranë në formën e një vegimi ai shkruan: «Isha me një shokun tim të ngushtë për gjah brigjeve të Bistricës. Unë dhe shoku im i ngushtë ecnim pranë e pranë drejt burimit të lumit, pranë fshatit Krongj... Duke ecur mbërritëm te gurra. Unë ju ngjita një shkëmbi dhe u futa në një si guvë të thellë. Pasi bëra disa hapa në guvë, vështrova një herë brenda, por nuk pashë gjë. Befas dëgjova si një gjëmim të fortë dhe gurë që rrokulliseshin me rrapëllimë... Ndërsa diçka si një vërshëllimë më bëri të mendohem për legjendën e lashtë të Bistricës. Dhe thirra me zë të lartë:

— Kush je ti aty?

— Unë jam legjenda e Bistricës, — dëgjova një si gjëmim.

— Ç'farë do?

— ...Po vhem në dispozicion të njerëzve, — m'u përgjegj — që të bëni ç'të doni me mua, të ndërtoni edhe digë hidrocentrali po të doni, ja aty më poshtë te fshati Krongj nga kalove qëpari. E kam fjalën për atë digë, që ti e ke gjithnjë në mendje... Me anë të kësaj dige do të elektrifikohen Saranda, Delvina, Gjirokastra, fshatrat e Dropullit, Dhivri, Dhrovjani...»

Për t'u çuditur është se diga e Bistricës për të kthyer ujët e lumit drejt tunelit të madh, është ndërtuar pikërisht aty ku kishte ëndërruar Lefteri, pranë fshatit Krongj. Dhe sot të gjitha ven-

det që përmend ai në ditar kanë marrë dritë nga hidrocentrali i madh i Bistricës...

Vegimi i Lefterit nuk mbaron me kaq. Lefteri pasi ëndërron për shpronësimin e çifligarëve dhe radhit fshatrat e Vurgut që do të përfitojnë tokë nga reforma agrare, vazhdon:

«...Pastaj vjen bonifikimi i Fushës së Vurgut, mekanika bujqësore, ngritja e digave në breg të detit atje te liqeni i Butrintit për të ndaluar baticën; po ka edhe më; pas tyre vjen puna e madhe për ndërtimin e shtëpive të bukura e të shëndetshme për fshatarët, vjen radha për kaq e kaq gjëra të tjera që Vurgu të bëhet një kopsht i vërtetë».

Dhe vegimi përfundon:

«Uh! Harrova shpimin e tokës për të gjetur naftë, spërkatjen e gjoleve të Almiroit dhe të Kokalit me aeroplanë...»

Kaluan vetëm tri dekada prej asaj dite që një i ri entuziazt dhe i frymëzuar nga idetë komuniste ëndërronte për gjëra, që asokohe mund të duke-shin si utopi. Dhe të gjitha këto gjëra janë bërë realitet nga populli ynë nën udhëheqjen e partisë. Por sa gjak u desh që dëshirat dhe aspiratat e njerëzve tanë më të guximshëm të kthehen në vepra të vërteta! Për realizimin e këtij qëllimi të madh dha gjakun e vet edhe Lefteri në lulen e rinisë!..

Gjatë kohës që qëndroi në shkollën e plotësimi në Tiranë Lefteri vëren me kujdes çdo gjë, shënon në ditar përshtypjet e tij nga jeta dhe shfaq mendimin e vet për problemet që e preokupojnë. Më datën 14.IX.36 në ditarin e tij shkruan:

«Pardje të shtunën bëmë një marshim në ma-

lin e Dajtit. U ngritëm në ora dymbëdhjetë të natës, u pregatitëm shpejt e shpejt dhe në ora një u nisëm me çanta shpine, helmata e trasta ushqimesh. Pesha gjithsejt 15-17 kg. Pas shtatë orësh, domethënë në ora tetë para dite, mbërritëm në vend. Atje kishte një shesh të bukur, pyje të mrekullishme dhe ujëra të bollshme...

Së andejmi panorama është shumë tërheqëse. Nga ana e jugut duket Tomori, nga e djathta Durrësi, pastaj një gjuhë drejt detit — Këneta e Durrësit — dhe më nga e djathta derdhja e Drinit dhe malet e Shkodrës. Para nesh shtrihet Tirana me rrugë të gjera e me shtëpi të mbuluara me tjegulla të kuqe (Tirana e kuqe me të vërtetë). Poshtë nga ana e djathtë shtrihet fusha, çaire dhe livadhe, si një rrip mjaft i gjerë dhe i blertë, i qëndisur me gardhiqe e me pemë gjer atje ku fillon deti... Po ç'e do? Gjithë sipërfaqja e fushës është pothuajse e papunuar...»

Nga ky shkrim e nga shkrime të tjera të këtij lloji del qartë se bukuritë e natyrës e tërheqin shumë Lefterin, por mbi të gjitha atë e shqetësojnë problemet e mëdha të kohës, shkaqet e varfërisë dhe të prapambetjes së vendit. Dhe spikat besimi i thellë se do të vijë një ditë që fushat do të punohen, që populli do të çajë përpara dhe Shqipëria do të bëhet vendi i begatisë...

Nga ditari i tij del e qartë se atë e shqetësonte shumë fati i njerëzve të varfër dhe ai preket thellë nga çdo hall e nga çdo fatkeqësi e tyre. Më datën 1.VIII.1936 shkruan, lidhur me një letër që kishte marrë nga fshati:

«Fatkeqësi... Dhe diçka më shumë se fatkeqësi mund të quhet lajmi që më dërgojnë nga shtëpia në

letrën e fundit: «Të dielën martuan Kriston, të mërkurën vdiq nusja». Ç'mund të thuash për këtë? Gjë e çuditshme. Si ndodhi kështu? Bëj me veten time njëmijë supozime... Sa keq më vjen. Edhe Kristua edhe nusja ishin që të dy jetimë e ishin rritur me halle... Tani cilin të qash më parë? Ah, sikur të isha edhe unë në fshat. Diçka mund të bëja që ta shpëtonim vajzën e ngratë... Sidoqoftë, po të isha atje për mirë do të isha e jo për keq... E gjora Vantho! (Emri i nuses). E pagove shtrenjtë edhe ti me rininë tënde gjendjen e mjeruar të Vurgut, prapambetjen e tij... Ja cili



Lefteri me nënën dhe me vëllezërit

është shkaku. Mistere sot nuk ka për asnjë çështje...»

Megjithëse rron larg vendlindjes mendjen e ka atje te fshatarët e varfër të Vurgut, që vuanin



të zitë e ullirit. Më datën 2.X.1936 shkruan në ditar:  
«Ka një javë që s'pushon shiu. Herë-herë bie një shi i imtë e monoton, herë-herë një shi i rrëmbyer me pika të trasha. Qielli është i zyrtë nga retë e zeza që na vinë nga ana e detit... Po fillon edhe të ftohtit. Pak nga pak shiu shtrëngon më shumë. Ata që janë jashtë vrapojnë të futen në kazermat e mëdha...

Në këtë çast mendja ime fluturon atje poshtë, në fushat e argjilta, që pak nga pak do të kthehen në një baltë të trashë... Mendja ime fluturon atje te lumenjtë e fryrë që ujërat e tyre të turbullta e të kuqe si gjak do të vërshojnë e do të mbulojnë çdo gjë...

Në këtë kohë të keqe shoh përpara meje një çoban që struket e mblidhet kruspull nën trungun e një frashëri të plakur dhe rrëqethet, i shkreti, nga të ftohtit e nga frika, sa herë që vetëtin.

Pak më tutje shoh një djalë që kullot viçat e kur bie një rrufe aty pranë vrapon me të katra duke bërtitur: «Oh, moj nëno!» Por ajo është larg dhe nuk e dëgjon, ajo gjendet në shtëpi, dhe merr në peqi vocrrakët e tjerë, që tulaten si zogjtë e pulës nën krahët e kllोकës...

Më thellë ende, nga ana e liqenit të Butrintit, që nxihet e fryhet nga juga e nga batica e fortë e detit, shoh një peshkatar. Peshkatari i gjorë lufton të nxjerë në breg varkën e tij të vogël, sa një magje shtëpie, e gdhundur në një trung të trashë shelgu; ai lufton që të shpëtojë nga tërbimi i detit, që kërkon ta mbulojë me dallgët e të bëhet varri i tij...

— Oh, moj nënë! — thërret kohë mbas kohe peshkatari, duke lëvizur me dëshpërim lopatën e

vetme, herë nga e djathta, herë nga e majta, si ndonjë karrocjer me një dorë...

Por edhe kur të dalë ndonjëherë në breg peshkatari i varfër, lagur gjer në palcë, duke marrë frymë me zor nga ankthi, ku të futet i shkretë? Atje në kasollen e tij prej kashte, të ngritur buzë detit ai nuk do të gjejë as ngrohtësinë e shtëpisë, as rroba të thata, që të ndërrohet dhe as një darkë të mirë që të marrë veten... I dërmuar nga lodhja e nga të ftohtit, i lagur dhe i uritur, ndez një çikë zjarr sa t'i theken pak rrobat nga jashtë e t'i lëvrijë pak gjaku në dejet e ngrira dhe menjëherë e zë gjumi, gjumi i paevitueshëm pas çdo lodhjeje të fortë. Dhe atëhere shtrihet me këmbët nga zjarri, mbliidhet kruspull i mbështjellur me një bërrucë zhele-zhele, që nuk mban asgjë... Ç'bën ti, o i gjorë? Ke siguruar vetëm këmbët, po shpatullat dhe gjoksin? Vaj medet!..

...Ti nesër do të ngrihesh me një kollë të thatë, që do të të çajë kraharorin, me sy të skuqura e të buhavitura, e me çehre të zverdhur si prej mehiti... Zjarrmia do të shkrijë fuqitë e tua të fundit e koka do të të rëndohet kur do të duash ta ngresh që të nisesh drejt varkës, që t'i biesh përsëri lopatës e të marrësh përpjetë lumit që të kthehesh në fshat... Dhe kur të arrish më në fund në fshat, i dërmuar dhe i pafuqishëm, do të shtrihesh në dyshak me drithma të forta, dhe atje do të rrish i shtrirë gjersa të vijë prifti. Po ku është mjeku? Përse nuk vjen mjeku? Oh! Mjekët tek ne nuk shkojnë atëhere kur është për të shëruar ndonjë të sëmurë, po për të bërë diagnozën e sëmundjes nga e cila vdiq njeriu!..

Pas pak do të dëgjohet kambana e vdekjes

e fshatit: din-dan! din-dan! Dhe fshatarët të habitur do të pyesin njëri-tjetrin:

— Ç'është, ore, ç'është? Ç'ka ndodhur?

— Vdiq Xheli!

— Ç'thua, ore? Unë dje fola me të.

— Po si, fole dje, po sot... Ai kishte qenë me të vërtetë në punë... po kjo ishte përpjekja e tij e fundit, ishte lamtumira e tij e fundit...»

Në shkrimet e Lefterit të asaj kohe predominojnë tema e vuajtjes dhe kryesisht jeta plot mundime e bujkut të varfër të Vurgut. Lefteri nuk del jashtë këtij kuadri të ngushtë lokal dhe nuk e lidh mjerimin e fshatarit të Vurgut me mjerimin e klasës punëtore dhe të fshatarësisë sonë, në një kohë kur letërsia jonë me Migjenin po shkruante shumë për këtë temë. Kjo gjë shpjegohet me faktin se Lefteri ishte ende një simpatizan i ideve komuniste dhe aspak një komunist i formuar, se Lefteri ishte i shkëputur nga lëvizja komuniste shqiptare. Prandaj megjithëse në shkrimet e tij ndjehet një farë optimizmi revolucionar prapë se prapë në këto shkrime ka iluzione dhe mendime jo të drejta për probleme të veçanta të kohës.

Gjatë kohës që qëndroi në Tiranë Lefteri pati telashe të shumta me drejtorinë e shkollës. Në ditarin e tij më datën 1.VI.1936 shkruan: «Të premten z. Kokalari — njëri nga përgjegjësit e shkollës së plotësimit — më sulmoi brenda në klasë. «Ti je propagandist, — më tha me zemërim, — organizon biseda me të tjerët. Të njoh mirë unë, ne kemi të dhëna edhe për veprimtarinë tënde të mëparshme edhe për qëndrimin tënd si student jashtë shtetit. Tani ti vazhdon propagandën...»

Ç'të bësh? Na ndjekin këmbakëmbës...»

Edhe në një rast tjetër shënon: «Pa bërë gjë, Kokalari më dënoi me tri javë privim liridaljeje të dielave...»

Pas mbarimit të shkollës ndërsa nxënësve të tjerë u dhanë gradën e aspirantit, Lefterit i dhanë gradën e kapterit. Por nuk mbaron puna me kaq. Kur kthehet në fshat e kapin përsëri gjoja për mos paraqitje në ushtri. Në një letër drejtuar një shoku të tij më 3.III.1937 Lefteri midis të tjerash i shkruante: «...Siç e di u lirova nëntorin e kaluar si kapter... Pardje, pa asnjë paralajmërim, më kapën në Sopik e më dërguan të shoqëruar në Aliko. Ditën tjetër më përcollën për në Sarandë... Së andejmi më nisën për në Baon «Seman» në Elbasan. Mbërrita në Tiranë thujse i sëmurë nga rru-ga që bëra i shoqëruar. Tani më komunikuan dënimin: 7 muaj të tjera ushtri! E pse? Sepse gjoja nuk jam paraqitur, ndërsa as që më kishin lajmëruar fare...»

Ishte e qartë se autoritetet donin ta mbanin Lefterin larg Vurgut, larg fshatarëve...

## NË PRAK TË LUFTËS

«...Pra, është më se e sigurtë, se brezi ynë do të luftojë» — shkruan Lefteri në ditar në kohën e luftës së Spanjës. Dhe në një rast tjetër duke bërë fjalë për shtërgatën e madhe që po afrohej, shënon: «Unë si njeri i luftës nuk ia kam hiç frikën asaj...»

Sa herë lexoj këto fjalë të Lefterit në fle-

toren e zverdhur nga koha, më kujtohet një ngjarje e vogël, që më ka lënë mbresë të thellë...

Mars 1939. Jemi në prak të 7 prillit, në prak të pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste. Që të dy ishim mësues fshati. Ai në Pepel të Dropullit, unë në Finiq të Vurgut. Një ditë të bukur në të hyrë të pranverës një djalë i vogël më sjell në shkollë një copë pusullë. Nga shkrimi e njoha menjëherë se letra vinte nga Lefteri. «Nesër në ora pesë të mëngjezit të takohemi në Qafën e Gjash-tës mbi Sarandë se do të bëjmë një shëtitje në Lëkurës», më shkruante. Asnjë shpjegim tjetër.

Të nesërmen në mëngjez, që ishte ditë e diel, u takuam në orën e në vendin e caktuar. Lefteri ishte shumë i përpiktë. Dhe këtë e kërkonte edhe nga shokët e tij.

Bashkë me Lefterin kishin ardhur edhe dy shokë të tjerë. Ai kishte marrë me vete një mandolinë ndërsa një nga shokët e tjerë kitarë.

— Ju të tjerët që s'keni ndonjë vegël muzikore do të na pregatisni drekën, — tha me shaka Lefteri.

U ngjitëm majë kodrës ku kishte qenë dikur fshati i Lëkurësit. Qëndruam mbi një shkëmb pranë gërmadhëve të fshatit. Përpara nesh shtrihej deti i kaltër dhe i pafund. Nga ana tjetër dukej fusha e përmbytur e Vurgut, me fshatrat e vogla buzë kënetës së mbuluar me kallama. Lefteri nxori mandolinën nga këllëfi dhe mori një valle popullore.

— Kërceni, de, një herë! — na u drejtua ne.

— Je shumë në qejf sot Lefter, nuk e dimë nga se, — deshi ta ngacmonte një nga shokët.

— Njeriu e ndjen nevojën e muzikës jo vetëm

kur është i gëzuar, — u përgjigj ai me seriozitet.  
— Unë sot këndoj që të mos qaj. Kur shikoj Vurgun në këtë gjendje të mjeruar më vjen të pëlças nga marazi...

Afër mbremjes zbritëm në Sarandë. Unë u nisa drejt hotelit që të zija vend për të fjetur.

— Tre shtretër zër, — më tha Lefteri.

— Pse tre? Ne jemi katër.

— Unë nuk do të fle këtu sonte. Do të nisem që tani.

— Për ku?

— Për në Pepel.

— Je në vete, Lefter? Në këtë orë do të nisesh për në Pepel? — ju drejtuam ne me një zë.

Pepeli mbante nga Saranda nja dhjetë-dymbëdhjetë orë më këmbë. Dhe rruga ishte e keqe, se ajo kalonte mbi malin që ndan rrethin e Sarandës nga ai i Gjirokastrës.

— Bën shaka Lefteri, — u thashë unë.

— Jo, e kam me gjithë mend, — u përgjegj ai prerë. Por do të pimë një kafe një herë e pastaj do të nisem menjëherë.

— Po ç'të shtrëngon të udhëtosh natën e të kapërcesh gjithë atë mal?

— Më presin nxënësit, pastaj ne duhet të mësohemi të ecim në malet tona edhe ditën edhe natën...

Piu kafën me nxitim dhe u nis. Ne e vështrojmë se si i ngjitej rrugës drejt Qafës së Gjashtës. Pas pak ai humbi në errësirën e natës.

Pas disa ditësh ndodhi tragjedia e 7 prillit. Trupat fashiste u pritën me pushkë edhe në Sarandë, rrugët e së cilës u lagën nga gjaku i bijve të popullit.

Pushtimi fashist i vendit e preku shumë Lefterin. Megjithatë ai nuk e humbi besimin dhe nuk ra në dëshpërim. Ai shpresonte se shtypja e huaj do ta zgjonte shpejt popullin tonë.

Italia fashiste pasi pushtoi Shqipërinë filloi shpejt agresionin kundër Greqisë.

Gjatë kësaj kohe, që njihet si periudha e luftës italo-greke, edhe për banorët e Vurgut e gjithë rrethit të Sarandës lindën vështirësi jo të vogla dhe rreziqe të mëdha. Lefteri, i cili në atë kohë gjendej në vendlindjen e vet, në vija të përgjithshme mbajti qëndrim burror dhe luftoi me ç'kishite në dorë për të mirën e popullit. Në ditarin e tij të asaj kohe shkruante: «Dhjetor 1940. Shumë ushtri të huaja kanë shkëlur në këtë vend. Por ushtritë e huaja kalojnë e ikin, kurse ne kemi lindur në këtë tokë dhe s'ka forcë në botë, që të na shkulë së këndejmi. Ne këtu në këtë vend kemi kaluar të mirat dhe të këqiat e të gjithë së bashku do të kalojmë edhe rrezikun që kemi përpara...»

Gjatë fazave të ndryshme të luftës italo-greke për popullsinë e Vurgut e të fshatrave të tjerë të rrethit të Sarandës lindnin vazhdimisht probleme të reja e të ngatërruara. Lefteri në atë kohë bashkëpunoi ngushtë me elementë të tjerë përparimtarë që mbronin interesat e popullit punonjës duke u përpjekur që të evitoheshin me të gjitha mënyrat vjedhjet, plaçkitjet, grindjet e përleshjet midis elementëve të ndryshëm. Kjo gjë në pamje të parë duket si një gjë e vogël dhe e kufizuar. Por në fakt për atë kohë ka pasur një rëndësi politike, sepse kështu ju dha një përgjigje e mirë propagandës së fashistëve italianë e të shovinistëve grekë, që nuk lenin gur pa lëvizur për të përçarë

popullin. Kështu u krijuan premisa të favorshme për atë vëllazërim të çelniktë, që farkëtoi partia pak më vonë gjatë luftës nacionalçlirimtare.

### «UNIVERSITETET E MIA»

Gjatë gjithë vitit 1941 Lefteri jetoi në ilegalitet. Pas kthimit të ushtrisë italiane ai qëndroi për një kohë në një kasolle gjysmë të shkatërruar, që e përdornin çobanët në muajt e dimrit. Tani emri i tij ishte bërë i njohur në të gjitha fshatrat e krahinës. Nga qëndrimi i tij i drejtë dhe i guximshëm gjatë kohës së luftës italo-greke ai kishte fituar një simpati në gjithë krahinën. Të gjithë njerëzit e ndershëm ishin gati që ta ndihmonin, ta strehonin e ta mbronin nga armiku.

Formimi i Partisë më 8 nëntor të vitit 1941 e gjeti Lefterin në ilegalitet. Ditari i kësaj periudhe, që vazhdonte të mbante ende, ka humbur, kështu që nuk dimë hollësisht nga kush e mori vesh këtë ngjarje të madhe për vendin tonë e ç'bëri konkretisht. Në këtë kohë nuk ruhej aq sa duhej dhe shumë herë dilte fshatrave. Po armiku përgjonte dhe në fillim të vitit 1942 kuestura italiane e arrestoi në fshatin e tij. Menjëherë pas arrestimit e çuan në Sarandë, ku e kaluan në hetuesi dhe e torturuan barbarisht. Por nuk arritën t'i nxjerrin asgjë. Pasi e mbajtën disa kohë në podrumet e kuesturës në Sarandë, e përcollën për në burgun e Vlorës.

Sokrat Çakalli nga fshati Pilur i Himarës, që asokohe gjendej edhe vetë i burgosur në burgun e Vlorës, në kujtimet e tia, midis të tjerave shkruan:



«Aty nga shkurti i vitit 1942 ndodhesha në burgun e Vlorës. . . Kishte kaluar pak kohë nga dita që isha arrestuar dhe sikur qeshë mësuar ca me jetën e vështirë të burgut dhe me kapriçot e gardianëve e të drejtorisë. . . Në ato ditë na sjellin në burg një djalosh të lidhur, të ligur e të torturuar për ibret. Djaloshi dukej i rraskapitur. Fashistët, që e sollën, e hodhën me inat e urrejtje në një qoshe të burgut. Ai në fillim ishte i dërmuar nga dhimbjet e meqë nuk njihte njeri në burg fliste fare pak. . . Shokët e burgut më caktuan mua që të merrsha me të porsaardhurin e të interesohesha për shëndetin e tij. Unë ju afrova menjëherë dhe mora vesh se ky djalosh ishte Lefter Taloja nga Vurgu i Delvinës. Unë kisha dëgjuar të flitej për të, që kur isha në fshatin tim. Përveç kësaj njihesha mirë me të jatin, Miço Talon. Bisedova me shokët dhe i siguroam menjëherë rroba të thata e ushqim, që të mirrte pak veten. Pastaj e informuam në vija të përgjithshme për gjendjen e burgut. . . Lefteri, megjithëse qëndroi pak kohë në burgun e Vlorës, u njoh shpejt me të gjithë shokët dhe zemra e tij nisi të çelej. . . Por një natë erdhën gardianët dhe, pasi e nxorën nga dhoma e lidhën fort dhe e morën me vete. Ne u shqetësuam se kishim frikë mos e morën për ta pushkatuar a për ta internuar në Itali. Ne u përshëndetëm dhe u përqafluam me Lefterin me ngrohtësi të madhe, sikur të njiheshim me të prej vjetësh. Ai në çastin e ndarjes u tregua shumë i fortë, gjë që na habiti të gjithëve. Dy muaj më vonë më transferuan edhe mua nga burgu i Vlorës në atë të Tiranës. Sa u habita dhe sa u gëzova kur u takova aty me Lefterin! Tani ishte ai që u interesua për mua. E them me gjithë

zemër se ai më priti si vëlla e u kujdes për gjithshka. Që natën e parë të qëndrimit tim në burgun e Tiranës Lefteri më tha: «Xha Sokrat! Këtu jemi shumë, por nuk jemi të gjithë të një brumi. Po ta marrësh nga jashtë të gjithë shqiptarë jemi, por midis të burgosurve ka nga ata që kanë hyrë në burg për krime ordinere, ka edhe të shitur. Ti e kupton edhe vetë se ke qenë në burgun e Vlorës. Ne, xha Sokrat, kemi këtu një kolektiv-mensë; në këtë kolektiv mund të hyjnë ata që aprovohen nga këshilli, që e kemi zgjedhur ne.



Lefteri, Thodhori Shanua dhe një grup fshatarësh.

Kuota për ushqim është sa të kesh; edhe kur s'ke fare, prapë mund të pranohesh në kolektivin tonë. Ja kështu e kuptojmë ne vëllezërinë, kolektivitetin që të ndajmë edhe kafshatën e fundit të bukës me shokun tonë, e po të jetë nevoja të flijojmë edhe veten për shokun. Unë do të bëhem garant për ty, që të pranohesh në kolektivin tonë...» **E**

përqafova Lefterin e doja t'i thosha se unë do të jem me ju gjer në vdekje, por nga mallëngjimi m'u pre zëri e nuk i thashë dot asnjë fjalë... Aty në burgun e Tiranës vura re se Lefteri mernte pjesë në mbledhje me komunistët e në aksione që organizonin të burgosurit. Shpeshherë Lefteri na fliste për çështje të ndryshme. Me sa zjarr fliste ai. Disa herë autoritetet e burgut u përpoqën që një pjesë të shokëve, së bashku me ta edhe Lefterin, t'i internonin në Itali, por protestat e fuqishme të të burgosurve e të popullit nga jashtë i shpëtuan ata nga internimi».

Pas dy-tre muajve Lefteri doli përpara gjyqit ushtarak. Akuzat e kuesturës italiane ishin të rënda. Por në mbrojtje të tij erdhën disa dëshmitarë nga fshatrat e nënprefekturës së Konispolit, që hodhën poshtë akuzat e kuesturës e folën shumë mirë për Lefterin. Haxhi Islami, një nga dëshmitarët e mbrojtjes në gjyqin e Lefterit, thotë: «Në gjyq është bërë një luftë e madhe. Ata i kishin ngjitur Lefterit shumë akuza, por të gjitha këto akuza ishin me hamendje. Ne që kishim ardhur nga fshatrat e Konispolit vetëm e vetëm për të mbrojtur Lefterin flisnim me fakte. Më në fund gjykata ushtarake u detyrua ta nxirrte të pafajshëm «për mungesë provash». Lefteri sapo dëgjoi këto fjalë u lëshua drejt nesh dhe na përqafoi të gjithëve me radhë. Pastaj të gjithë së bashku dolëm nga salla e gjyqit të gëzuar e të emocionuar. Për ne kjo nuk ishte gjë e vogël. Kishim fituar një betejë kundër armikut. Mirëpo fashizmi është shumë dinak e i pabesë. Dhe këtë pabesi e vuri menjëherë në veprim. Pasi u çmallëm pak me të, Lefteri na tha: «Tani unë do të kthehem një herë në burg për

t'u përshëndetur me shokët e për të marrë disa gjëra të vogla që kam atje». Dhe u nda nga ne, që të kthehej përsëri pas nja dy tri orësh. Ne e pritëm gjer vonë por ai nuk dukej. Të nesërmen në mëngjez morëm këtë përgjegje: «Lefteri u mbajt në burg. Meqë u arrestua në nënprefekturën e Konispolit nuk mund të lirohet këtu në Tiranë, por do të përcillet nga burgun në burg gjer në Konispol...» Ç'gënjeshtër pa kripë! Ne e kuptuam menjëherë arësyen e vërtetë: kuestura italiane nuk ishte dakord për lirim të tij. Dhe për ta çuar Lefterin nga burgun e Tiranës në atë të Gjirokastrës u nevojitërkërkuan më shumë se gjashtë muaj...»

Sokrat Çakalli, që vazhdonte të ishte në burgun e Tiranës shkruan në kujtimet e tij: «Lefteri doli në gjyq e mori pafajësinë. Megjithatë SIMI e mbajti përsëri në burg dhe pastaj e transferoi në burgun e Gjirokastrës, si një propagandist të rrezikshëm komunist...»

Gjatë transferimit të tij nga burgun e Tiranës në atë të Gjirokastrës, Lefteri qëndroi disa ditë në burgun e Vlorës. Atje u njoh me Shefqet Peçin, i burgosur edhe ai në atë kohë në burgun e Vlorës. Shoku Shefqet Peçi lidhur me këtë tregon: «Një natë gardianët thirrën emrin tim e atë të Lefter Talos. Kur dolëm në korridor na thanë që të mirrim edhe plaçkat tona. Duke zbritur shkallëve Lefteri më pyeti: «Ku do të na çojnë vallë?» Unë dyshoja shumë se mos kishin ndër mend të na internonin në Itali. Po nuk i thashë gjë Lefterit. Jashtë na priste një autobлиндë. Na futën që të dyve në autobлиндë e me mitraloz të ngrehur na çuan në burgun e Gjirokastrës. Ne ishim të burgosur e të lidhur; por ndjenim një kënaqësi se shi-

konim armiqtë tanë që dridheshin nga frika e ndonjë sulmi nga ana e partizanëve. Ndaj na kishin bërë «nderin e madh» për të na çuar me auto-blindë. . .»

Në burgun e Gjirokastrës Lefteri ndenji disa muaj bashkë me Shefqet Peçin dhe u bë një bashkëpunëtor i tij i ngushtë. Në librin e tij «Kujtime dhe dokumenta nga Lufta nacionalçlirimtare» Shefqet Peçi midis të tjerave shkruan: «Lefteri edhe kur ndodhej në burg ishte shumë i vendosur për zbatimin e urdhërave të partisë, të cilat i kryente me përpikmëri. Kjo e bëri të pranohej si anëtar partie që në burg. . . Lefteri dallohej midis shokëve të tij nga temperamentin revolucionar, nga dashuria dhe kujdesi për shokët. Ai ishte shumë i shkuar me fshatarët e punëtorët dhe i papërtuar për zbatim urdhërash».

Në burgun e Tiranës, të Vlorës e të Gjirokastrës Lefteri qëndroi afro një vit. Ai ishte arrestuar menjëherë pas formimit të Partisë Komuniste Shqiptare dhe u lirua nga fundi i vitit 1942, kur lëvizja nacionalçlirimtare po mirrte hov të madh. Në atë kohë njerëzit e partisë, që ishin arrestuar nga armiku zhvillonin një punë të madhe nëpër burgjet e ndryshme të vendit. Lefteri i kishte simpatizuar prej kohe idetë komuniste, por kishte mbetur një komunist i pa formuar. Ai duke jetuar për një kohë të gjatë si i shkëputur në fshat, nuk ishte i qartë për shumë gjëra dhe kishte nevojë të madhe për ndihmën e shokëve të partisë që e sqaruan atë plotësisht për themelimin e Partisë dhe për detyrat e mëdha që shtronte ajo. Dhe ai këtë ndihmë të shokëve të Partisë, që vinte në kohën e duhur, e priti me zemër të hapur e me

entuziazëm. Duke bërë fjalë për jetën e tij në burg ai shkruan në fletoren e shënimeve. «Kur mbarova shkollën e mesme kisha një dëshirë të madhe për të vazhduar studimet e larta. Por dyert e universitetit ishin të mbyllura në atë kohë për ne... Unë për një arësye a për një tjetër nuk arrijta as të regjistrohesha në ndonjë fakultet... Po atë që s'do ta gjeja në asnjë universitet e mësova në burgjet e Tiranës e të Gjirokastrës, që janë me të vërtetë universitetet e mia... Në këto universitete mësova si duhet luftuar për çlirimin e plotë të popullit punonjës nga kthetrat e pushtuesit dhe të shfrytëzimit. Shkurt, këtu përqafova një herë e mirë vijën e Partisë Komuniste Shqiptare, vijën e Partisë time...»

Nga burgu i Gjirokastrës ai doli si komunist i gatshëm për punë praktike revolucionare. Ai tani ka edhe një emër tjetër, pseudonimin e tij, dhe me këtë emër të ri ai do të thirrej nga të gjithë shokët e tij të luftës. Me pseudonimin «Muzhik» ai do t'i firmosë tani e tutje të gjitha letrat dhe raportet që ka shkruar gjatë luftës. «Këtë pseudonim, — thoshte, — e kam zgjedhur vetë, se më kujton rrugën revolucionare të fshtatarësisë së varfër ruse nën udhëheqjen e Partisë bolshevike të Leninit...»

### «ORA E LUFTËS KA RA...»

Lefteri doli nga burgu i vendosur plotësisht që të fillonte menjëherë nga aktiviteti revolucionar. Në fletoren e tij të shënimeve, gjatë ditëve

të para të jetës jashtë burgut, shkruan: «Partia ka ndezur një prozhektor të fortë, që na ndriçon rrugën e jetës. Vetëm ata që janë të verbër nuk e shohin këtë dritë të fuqishme e shpëtimtare; përveç armiqve sigurisht, që kjo dritë e madhe u verbon sytë...»

Në familje qëndroi vetëm dy ditë. Ditën e tretë u bë gati të nisej për në Gjirokastrë, ku e kishin thirrur shokët e komitetit qarkor të partisë. Ata të shtëpisë u habitën kur e panë që u bë gati për rrugë.

— Kaq shpejt do të na ikësh, Lefter? — i tha si me ankim e ëma. — Ne hala s'të pamë or djalë, ç'bën kështu ti? Se të kishim në gojë të ujkut dhe tani donim të çmalleshim pak me ty.

— Edhe unë dua, moj nënë, — ju përgjegj ai, — por nuk na pret koha. Nuk shikon se ç'po bëhet?

Lefteri me këto fjalë të fundit donte t'i thoshte së jëmës për zhvillimin e vrullshëm të ngjarjeve. Gjatë periudhës prej afro një viti, që ai kishte qenë në burg gjendja politike e vendit, si edhe ajo ndërkombëtare, kishte ndryshuar fund e krye. Në Frontin e Lindjes, ku luheshin fatet e Luftës së dytë botërore, Ushtria e Kuqe e Stalinit kishte rrethuar në Stalingrad armata të tëra gjermane dhe u jepte goditje shkatërronjëse. Pas disa javësh repartet më të zgjedhura të ushtrisë fashiste gjermane do të dorëzoheshin me turp në duart e ushtarëve sovjetikë. «Perëndimi i ushtrisë gjermane», siç thoshte Stalini, dukej tani fare qartë. Në vendin tonë kushtrimi që kishte lëshuar Partia Komuniste për luftën e armatosur kundër pushuesve dhe tradhëtarëve të vendit, po ngrinte pesë gjithë popullin tonë të shumëvujtur, por të

papërkulur përpara armiqve. Fjala e zjarhtë e partisë po përhapej me shpejtësi edhe në krahinat e në fshatrat më të largëta të vendit. Në fshatrat e Delvinës, të Sarandës e të Konispolit po vihej re një lëvizje e ethshme për formimin e çetave të para partizane, Edhe Vurgu, i shfrytëzuar gjer në palcë nga agallarët dhe këlyshët e fashizmit, po ngrihej në luftën çlirimtare.

Në ditarin e Lefterit ku shënimet bëhen gjithnjë më të rralla, gjejmë vetëm këto rreshta të shkruara ditën e parë a të dytë pasi doli nga burgu: «Ka ardhur ora e veprimit, ora e luftës vendimtare. S'kemi si të presim më as edhe një minutë. Mjaft kemi pritur! Partia na prin...»

Në Gjirokastër Lefteri mori pjesë në një mbledhje të gjerë që kishte organizuar komiteti qarkor i partisë me kuadro të krahinave të ndryshme të ish-qarkut të Gjirokastrës. Nga sa kallëzojnë pjesëmarrësit e kësaj mbledhjeje Lefteri foli për formimin e çetës së parë në krahinën e Konispolit. Po në këtë mbledhje ai u caktua zëvendës-komisar i çetës, që do të formohej disa ditë më vonë dhe që u quajt Çeta «Çamëria».

Pas kthimit nga Gjirokastra ai hidhet menjëherë në ilegalitet dhe merret kryekëput me aktivitet revolucionar. Në bashkëpunim me shokët e tjerë të partisë ai gjithë veprimtarinë e tij e përqëndron në dy drejtime: në çarmatosjen e postë-komandave të armikut, që gjendeshin ende në krahinën e Konispolit e të Delvinës, dhe në formimin e çetës së parë partizane të kësaj krahine.

Tani ai s'ka më kohë që të mbajë shënime në ditare. Janë ditët e vrullshme të organizimit të luftës së armatosur nën udhëheqjen e partisë,



kundër armiqve të jashtëm e të brendshëm. Aktivitetin e tij tani e tutje do ta ndjekim më shumë nga tregimet e shokëve të ngushtë e nga raportet e ndryshme që i dërgon Komitetit qarkor të partisë për qarkun e Gjirokastrës dhe që i firmos gjithnjë me pseudonimin «Muzhiku». Në raportin e tij të parë dërguar komitetit qarkor në ditët e para të shkurtit të vitit 1943 mbi zhvillimin e lëvizjes në krahinat e Vurgut e të Çamërisë, midis të tjerash ai shkruante: «Pas mbledhjes në Gjirokastrë në ditët e para të shkurtit, së bashku edhe me shokë të tjerë të minoritetit, zbrita në Delvinë dhe atje bisedova me shokët për ndihmën që duhet t'i japë lëvizjes populli në të holla e materiale. Në Hoxhë gjeta mbledhjen e përfaqësuesve të fshatrave të komunës së Pandelejmonit. Mora pjesë edhe unë... Me 7.II.1943 mobilizova elemente të mirë në katunde të Vurgut, formova me ta grupe edukative dhe i ndërliha me Delvinën. Me 12.II.1943 postëkomanda e Sopikut u gatit për t'u larguar e zbriti në xhade. Më ftuan shpejt të takohesha me ata të Çamërisë për t'i sulmuar... 12 xhandarë shqiptarë erdhën me ne, 5 karabinierë italianë i nisëm të shoqëruar për në Konispol. Morëm 3 arka (350) bomba dorë e dy arka me fishekë...»

Në atë kohë në fshatrat e Vurgut e të Konispolit veptoi për disa ditë çeta e Kurveleshit, që në dokumentat e asaj kohe përmendet si Çeta e «Çakallit» (pseudonimi i Dilaver Poçit). Çeta në fjalë hapi depot ku ishin grumbulluar të dhjetat e fshatarëve dhe ua shpërndau bereqetin fshatarëve të varfër, goditi postat e armikut dhe bëri punë sqaronjëse politike në popull. Lefteri në një raport

tjetër për komitetin qarkor të partisë shkruante: «Ardhja e çetës së «Çakallit» në Vurg ngjalli një simpati shumë të madhe. Pjesëtarët e celulës të çetës në fjalë janë të njohur e respektohen nga të gjithë si në Vurg edhe në Delvinë... Çeta e «Çakallit» dhe lëvizja e saj nëpër fshatrat e Vurgut bëri efektin më të madh...»

Nga mesi i shkurtit Çeta e «Çakallit» goditi postat e armikut në Leshnicë të Poshtme e në Zminec. Në këto luftime mori pjesë edhe Lefteri i cili tregoi guxim e trimëri. Ai i njihte mirë këto vende dhe dha një ndihmë të madhe në përgatitjen dhe në zbatimin e planit të sulmit kundër këtyre postave të armikut. Siç del nga një komunikatë e Komitetit qarkor të partisë për Gjirokastrën në postën e Leshnicës u çarmatosën pesë xhandarë shqiptarë e pesë karabinierë italianë, ndërsa në atë të Zminecit dy italianë u vranë dhe 19 u zunë robër.

Pas çarmatosjes së këtyre postave të armikut, u krijua një zonë e lirë mjaft e gjerë, që fillonte nga kufiri me Greqinë e arrinte gjer në lumin Bistricë, pranë Delvinës. Lidhur me krijimin e kësaj zone të lirë, Lefteri në një raport të tij shkruante: «I dërgova «Çakallit» lajmëtar që të mbronte Bistricën e Kranenë me patrulla dhe urën e Kranesë ta shtatërronte...» Disa ditë më vonë në një komunikatë të komitetit qarkor për veprimtarinë e çetave thuhet: «Më 20.II.1943 ora 3.30 pas mesnate ura e Kranesë u hodh në erë...»

Nga ana e tij komandanti i çetës, Dilaver Poçi, i raportonte ato ditë Komitetit qarkor të partisë për Gjirokastrën: «Çeta u fut mirë në Vurg. Kemi besim të plotë. Në bisedimet ka marrë pjesë edhe «Muzhiku».

Në ato ditë të stuhishme në fshatin Markat të Konispolit u formua e para çetë e këtyre anëve, Çeta «Çamëria». Lefteri u caktua zëvendëskomisar i saj.

Në raportet e para menjëherë pas krijimit të Çetës «Çamëria» Lefteri i raporton komitetit qarkor të partisë: «Më 20.II.43 u kapën në pritë 65 milicë italianë në rrugën midis fshatrave Shalës-Dishat. U mbajtëm një konferencë dhe i liruam. Ata brohoritën: «Vdekje fashizmit! — Liri Popullit! Poshtë Musolini!» Na dhanë fjalën se do të arratiseshin... Me 21.II.43 i shpërndamë popullsisë së varfër 70 kv. misër të së dhjetës në fshatin Ninat. Më 24.II.43 u shpërnda e dhjeta e Markatit dhe më 1.III.43 e dhjeta e Vagalatit prej 280 kuintalësh... Gjatë këtyre ditëve çeta përshkoi katundet: Dishat, Vërvë, Janjar, ku u mbajtën konferenca. Në Perdhikar e Karroq u takuam me një përfaqësi të një çete partizane greke, me të cilën biseduam për bashkëpunim. Përfaqësia greke u largua. Ne vazhduam rrugën tonë për në fshatra Grazhdan, Zminec, Qesarat, Gravë, Pandelejmon. Kudo u mbajtën konferenca në popull dhe u formuan këshilla nacionalçlirimtare...»

Çeta «Çamëria» brenda një kohe të shkurtër u shtua shumë. Me dt.28.II.43 Lefteri i raportonte komitetit qarkor të partisë: «Çeta i kaloi të 100 vetat...» Pas disa ditësh ai raporton përsëri: «Çeta prej fillimit e gjer më dt. 13.III.1943 arriti në rreth 200 veta. Me datën 13.III.1943 çeta u seleksionua dhe mbetën 60 vetë. Të tjerët u dërguan në Markat, Ninat, Janjar, Shalës, Dishat e Vërvë për të bërë pjesë në njësitet guerrile...»

Nga këto raporte të shkurtëra e me stil tele-

grafik mund të kuptohet fare mirë shpejtësia me të cilën përhapej flaka e luftës popullore kundër pushtuesve e tradhëtarëve dhe pjesëmarrja në masë e rinisë dhe e gjithë popullit në formacionet e armatosura të krahinës. Mirëpo në Çetën «Çameria» që në fillim nuk shkon çdo gjë në rregull.

Komandanti i çetës ishte caktuar Haki Rushiti, i cili pa mbushur një vit tradhëtoi lëvizjen nacional-çlirimtare dhe u hodh nga ana e armikut. Lefteri, së bashku me shokë të tjerë komunistë, duke luftuar për të vënë në jetë vijën e partisë, qysh në fillim ra në kundërshtim të hapur me këtë element ambicioz e kapadai, që s'kishte asgjë të përbashkët me komandantët popullorë të Ushtrisë sonë nacionalçlirimtare. Lefteri, në një raport të tij dërguar në atë kohë komitetit qarkor të partisë, midis të tjerave shkruan: «...Puna u ngatërrua. Duke kërkuar disa shpjegime nga komandanti ushtarak (Haki Rushiti) mbi pakujdesinë në komandimin e forcave, që lanë milicinë e ardhur nga Saranda të kalonte, kuptova qartë se ky pozitën e komandantit ushtarak e kupton: komandues dhe përgjegjës absolut. Ai s'pranon as këshilla, asgjë. Shumë njerëz mendojnë, si unë për këtë, por nuk mund të dalin hapur tani kundër tij, se s'është ko-ha...» Duke bërë fjalë për Haki Rushitin një i deleguar i komitetit qarkor të partisë në një raport të dërguar atij komiteti nga Konispoli e quan atë «bajraktar të komunizmit». Lefteri çështjen e komandantit kapadai e ngrë edhe në raporte të tjera. Për të ndrequr këtë situatë Lefteri propozon: «...Ardhja e shokut Shefqet (Peçit) si komisar do të jetë e vetmja zgjidhje; se vetëm një element me ndikim, me eksperiencë ushtarake dhe i pjekur mund të pranohet prej këtyre...»

Komiteti qarkor i partisë merr masa dhe dërgon disa kuadro të rëndësishme për të ndihmuar Çetën «Çamëria», që sapo qe formuar. Shoku Shefqet Peçi në librin e tij «Kujtime dhe dokumenta nga Lufta Nacionalçlirimtare» shkruan lidhur me këtë: «2 mars 1943. Komiteti qarkor i Gjirokastrës më caktoi mua, Grumin (Memo Meto) Rrufenë (Ali Lala) dhe Breshërin (Xhelo Fasliu) për të shkuar në krahinën e Konispolit, që të ndihmonim në organizimin e Çetës «Çamëria»... Në Shalës të Konispolit u bë mbledhja e Çetës «Çamëria», u formua organizata e partisë në çetë. Kjo ndodhi me 14 mars 1943... Për masat që mori ekipi i dërguar ju raportua Komitetit qarkor të partisë për Gjirokastrën».

Duke bërë fjalë për Lefterin e për aktivitetin e tij në atë kohë shoku Shefqet Peçi shkruan: «... Është data 12 mars 1943. Unë, Memo Metoja, Lefter Taloja e disa shokë të tjerë kishim shkuar në një konferencë për forcimin e këshillit në katundin Mursi të Konispolit. Populli ishte mbledhur i tëri dhe dëgjonte me kujdes konferencën që zhvillohej... Në këtë mbledhje merrte pjesë edhe Dine Janoja, një burrë 65 vjeç, pronar i 6000-7000 krerë bagëtie dhe shumë pasurive të tjera. Siç doli atje Dine Janoja as më parë dhe as në këtë konferencë s'kishte marrë vesh se ç'ndodhte në vendin tonë. Kjo u duk hapët kur mbaroi konferenca, sepse Dine Janoja thirri: «Rroftë Ahmet Zogu». Lefteri, i cili ishte pak gjaknxehtë dhe s'i duronte dot këto budallallëqe, deshi të vepronte kundër Dines, po ne e ndaluan duke i thënë «Lere se ai s'di ç'thotë dhe s'di ku gjendet; nuk e shikon si tallet populli me të?» Lefteri u ndal po ç'i mbante të tjerët. Njerëz

nga populli u ngritën dhe dikush e kritikonte, dikush e tallte Dinen. Njëri i tha: «Ti xha Dine mendove se ne luftojmë për Ahmet Zogun tënd, që i shpurre 40 desh kur u martua. Jo mor i zi jo. Ne luftojmë edhe kundër Ahmet Zogut, që të mos kthehet kurrë më, se populli do liri dhe qeveri të tijën, kështu që edhe peshqeshi yt që i bëre Zogollit vate dëm se s'ka se si të ta shpërblejë më. Ai do vdes në arrati si armik i popullit dhe nëma e popullit do ta ndjekë pas kudo, se ai na varfëroi sa deshi dhe na shiti te italianët e Musolinit.

Dine Janua u turpërua shumë nga kjo që i ndodhi, mbasi ai deri atëhere kish kujtuar se kish bërë mirë, ai s'kishte kuptuar asgjë, nga konferenca që u mbajt aty. Ai mendonte se gjithë lufta që bëhej kundër okupatorit, bëhej për kthimin e Ahmet Zogut në fuqi. Dine Janua dinte vetëm të shtonte dhëntë e meritë, por hala nuk kishte marrë vesh që Lufta nacionalçlirimtare bëhej jo vetëm kundër okupatorit, por edhe kundër armiqve të vendit, bejlerëve e agallarëve, që i pinin gjakun popullit. Lefter Talos nuk ju durua, por prapë filloi të fliste. Lefteri ishte një luftëtar i vendosur, një njeri revolucionar, por shumë nevrrik dhe i pafrenuar. Megjithëse populli e talli rëndë Dine Janon, Lefteri përsëri ju drejtua Dines me fjalë të ashpra, duke i thënë: «Jo, Dine Jano. Zilet dhe këmborët e kopeve të tua mjaft e kanë shurdhuar dhe po e shurdhojnë popullin e Vurgut; prandaj kjo luftë do t'i vulosë këto këmborë një herë e mirë, që të mos e shurdhojnë më popullin; ose, që ta dish më mirë, ato shpejt do të bëhen të popullit» ... Ne nuk donim që t'i flitësh në këtë mënyrë Dine Janos, d.m.th. ta preknim në interesin e tij

personal; ne donim që ta tërhiqnim edhe atë në lëvizje. Mirëpo Lefteri ngaqë kishte vojtur shumë në regjimet e mëparshme, mbasi gjithënjë ishte burgosur si njeri përparimtar, shpeshherë shfrente hapët kundër të lëkundshmëve. Lefteri e humbiste durimin dhe kërkonte gjithmonë goditjen e tyre zjarr për zjarr, megjithëse ishte ende në fillim dhe duhej manevruar. Dine Janoja përfundoi kundër nesh dhe djemtë e tij më vonë u bënë me armikun. Prandaj Lefteri, duke i njohur mirë këta tipa, nuk ua mbante fare. Ai vazhdimisht fliste me një gjuhë të ashpër me ta, kur i binte rasti në biseda e në mbledhje. Shpeshherë ai thoshte: «Këta janë qen të pabesë e të kafshojnë në befasi, prandaj u duhet prerë koka...»

Lefteri gjatë kohës që qëndroi në Çetën «Çamëria», mori pjesë në të gjitha luftimet që zhvilloi ajo, si në Konispol, në Dhrovjan, në Muzinë, Libohovë e gjetkë. Dhe në të gjitha këto luftime ai u dallua si një luftëtar i patrembur. Krahas kësaj ai u tregua një propagandist e agjikator i palodhur dhe i talentuar i vijës së drejtë të partisë për çlirimin e popullit e të atdheut nga pushtuesit e nga bashkëpunëtorët e tyre. Për këtë veprimtari të tij ai fitoi dashurinë e simpatinë e masave e në mënyrë të veçantë të rinisë; por nga ana tjetër fitoi edhe urrejtjen e thellë të pushtuesve dhe të reaksionarëve të çdo kallëpi.

Në pranverë të vitit 1943 reaksioni ballist dhe elementët reaksionarë në minoritet, që vepronin sipas udhëzimeve që mirrnin nga organizata reaksionare e Zervës në Greqi, pasi mblodhën veten nga goditjet e rënda që kishin marrë nga lëvizja nacionalçlirimtare në muajt e parë të vitit, kaluan

përsëri në kundërsulm. Këtë veprimtari të tyre ata e koordinonin me operacionet që organizonin push-tuesit italianë në shumë krahina të vendit, duke djegur fshatra të tëra e duke zbatuar një terror të shfrenuar në kurriz të popullit. Nga ana tjetër agjentët e Zervës kalonin me radhë nëpër fshatrat minoritare duke u përpjekur të gënjenin sa më shumë njerëz me parullat e tyre helmatojnëse të përçarjes e me stërlina angleze. Ballistët dhe zervistët i shqetësonte në mënyrë të veçantë bashkimi i popullit nën flamurin e partisë. Ndaj dhe objektivi kryesor i tyre ishte përçarja e popullit me anë të mashtrimit. Në një raport që i dërgonte Komitetit qarkor të partisë për Gjirokastrën, Lefteri midis të tjerash shkruante: «Armiku përgjon e punon. Propaganda filo-angleze po punon që të ngrihen kundër lëvizjes sonë të krishterët e kësaj ane.

Në pranverë të vitit 1943 Çeta «Çamëria», me urdhër të Komitetit qarkor të partisë për Gjirokastrën del nga krahina e Delvinës dhe e Konispolit e kalon në zona të tjera për të marrë pjesë në sulmet e kombinuara të forcave partizane të qarkut kundër qyteteve dhe bazave të tjera të armikut. Duke kaluar në zonën e Libohovës çeta bëri edhe një punë të madhe propagandistike dhe agjitative nëpër fshatrat nga kalonte.

Isuf Çobani nga fshati Nepravishtë i Libohovës e veteran i lëvizjes nacionalçlirimtare në qarkun e Gjirokastrës, tregon një ngjarje interesante për Lefterin: «Çeta «Çamëria», — thotë Isufi, — si në të gjitha fshatrat e tjera të krahinës sonë bëri një mbledhje edhe me banorët e fshatit Peshkëpi të Rrëzës së Zezë. Në këtë mbledhje foli Lefter Taloja. Populli i katundit e ndiqte me interesim



të madh folësin, se Lefteri fliste aq bukur dhe aq qartë sa që i bënte për vete dëgjonjësit. Lefteri, pasi foli për gjendjen e jashtme dhe të brendshme, si dhe për detyrat e kohës, filloi të demaskonte me forcë disa parulla përçarëse që përhapnin asokohe në fshatrat tona elementët reaksionarë, si ata që ishin lidhur me Ballin, ashtu edhe ata që i shërbenin Zervës. Lefteri qëlloi në shenjë, se edhe në Peshkëpi të Rrëzës së Zezë kishte elementë të tillë, që donin të përhapnin panikun dhe përçarjen. Dhe kjo u duk haptazi atë natë. Sa mbaroi fjalimin Lefteri, ngrihet prifti i fshatit dhe i thotë: «Si shumë të bukur na e paraqite gjendjen, or djalë».

«Si dëshironte hirësia juaj, ta paraqisja me ngjyra të errëta? Kështu të pëlqen ty?» — e ndërpreu aty për aty Lefteri.

«E di ku e kisha fjalën? — e mori përsëri fjalën prifti. — Ti na the se partizanët rrëmbyen armët që të luftojnë kundër pushtuesve italianë e t'i hedhin në det si më 1920».

«Edhe më keq këtë **radhë**» — u hodh e tha Lefteri.

«Një minutë, të lutem. Të themi se ju e mundët Italinë; po dihet se ajo nuk është vetëm. Italia ka një aleat më të fuqishëm se vetja. Ç'do të bëni, pra, ju, po të vinë këtu gjermanët, që kanë bërë zap gjithë Evropën?»

«Po të vijë gjermani, uratë, do t'i tregojmë edhe atij vendin. Me plumb do ta presim edhe atë. Të jesh i sigurt për këtë që të them».

Prifti qeshi një herë si me ironi, por nuk u dha; ai përdori armën e fundit, me të cilën mendonte se do ta dërmonte Lefterin. «Po pastaj? — i tha. — Ç'farë do të bëhet pastaj? Mos mendo se

me kaq e keni fituar davanë. Se kundër jush është edhe Anglia. Çfarë do të bëni ju me një pushkë e me një grusht fishekësh në torbë, po të vijë anglezi me ato vaporet e mëdha, që bëjnë të dridhet bota?»

Lefteri nuk u përmbajt më. «Mund të dridhesh ti, o prift, dhe ata pak njerëz që të shkojnë pas — ju lëshua me vendosmëri Lefteri. — Pa popujt, që thua ti, luftojnë sot trimërisht kundër fashizmit. Unë e di se ti e ke në zemër anglezin dhe i bën duva perëndisë tri herë në ditë që të zbarkojë ndonjë mëngjesh të mirë edhe këtu tek ne. Po dije mirë, ama, se nuk do të bëhet jotja. Se ne do t'i biem edhe anglezit, po të përpiqet të fusë hundët në punët tona dhe çdo të huaji tjetër që do të guxonte të na shkelte vatanin. Ne jemi vegjëlta, populli dhe armët, që morëm nuk do t'i lëshojmë nga dora para se të arrijmë fitoren e plotë...» Përgjegjja e vendosur e Lefterit e bëri priftin që të mos dinte nga t'ja mbante. Populli e vuri menjëherë në lojë. Fjalët e Lefterit për demaskimin e priftit dinak e reaksionar u përhapën edhe në fshatrat e tjera të Rrëzës së Zezë e të Dropullit».

Në verë të vitit 1943 Çeta «Çamëria» u riorganizua në batalion, që pak më vonë mori emrin Batalioni «Thoma Lula». Po në atë kohë Lefteri u thirr nga komiteti qarkor i partisë dhe u ngarkua me një detyrë që në bashkëpunim me shokë të tjerë të terrenit të grumbullonte të rinj nga fshatrat minoritare, që kishin shfaqur dëshirën të dilnin partizanë, e të formonte me ta një çetë të re. Ishte nga fundi i korrikut. Lefteri u nis nga Nivani i Zagorisë së bashku me komandantin e çetës së Pogonit, Panajot Panon e me shokë të tjerë për

të kaluar në fshatrat e Dropullit e në ato të Rrëzës së Delvinës. Italia fashiste ndodhej në prak të kapitullimit. Bisha fashiste, e plagosur për vdekje në frontet e luftës si dhe në prapavijat e saj të thella, organizonte operacione pas operacionesh kundër zonave të lira të qarkut të Gjirokastrës. Kur Lefteri me shokët e tij arritën në Labovë morën vesh se ushtritë italiane po sulmonin me forca të mëdha në drejtim të Lunxhërisë. Ata e ndërprejnë udhëtimin dhe u bashkuan me forcat partizane që luftonin kundër italianëve.

Në ato ditë u përhap lajmi për krimin e shëmtuar të ballistëve në fshatin Glinë të Rrëzës së Zezë. Forcat balliste të Libohovës, me komandant kriminelin me damkë Nexho Bejlerin, në ditët e para të gushtit të vitit 1943, pasi vranë disa njerëz të pafajshëm në Labovë e në Libohovë, vajtën e rrethuan Glinën. Në këtë operacion terrorist ballistët u ndihmuan edhe nga reparte të ushtrisë italiane në Jorgucat, që kishin bllokuar fshatin nga ana e fushës. Ballistët u futën në Glinë si të tërbuar, dogjën një pjesë të mirë të fshatit dhe plaçkitën shtëpitë e katundarëve. Kur u larguan nga Glina morën me vete thuajse të gjithë burrat e të rinjtë, që kishin gjetur në fshat. Në të perënduar të diellit andej nga rruga për në Libohovë u dëgjuan krisma mitralozi, automatikësh dhe pushkësh. Gratë e fshatit vrapuan andej dhe në një përrua të thellë gjetën kufomat e burrave e të djemve të tyre të masakruar. Ballistët, me një egërsi shtazarake, kishin lënë të vrarë në vend 26 burra të pambrojtur. Ballistët me këtë krim të shëmtuar që ishte kulmi në serinë e përpjekjeve që kishin filluar prej kohe, në marrëveshje të fshehtë edhe

me elementët reaksionarë në minoritet, synonin të arrinin dy qëllime: nga njëra anë të përçanin popullsinë e fshatrave minoritare, që po bashkohej gjithnjë më ngushtë me popullin shqiptar në gjirin e Frontit Nacionalçlirimtar, dhe nga ana tjetër të frikësonin rininë, që donte të merrte pjesë aktive në luftën e armatosur kundër pushtuesve e tradhëtarëve. Por në realitet ndodhi krejt e kundërta...

Shoku Enver në referatin e mbajtur në Konferencën e II nacionalçlirimtare, datë 6.IX.1943, duke bërë fjalë për veprimet përçarëse të ballistëve në qarkun e Gjirokastrës, ka thënë: «Kanë djegur fshatra të krishtere të minoritetit grek për të ndarë minoritetin. Kurse minoritarët kanë dhënë prova për lirinë e Shqipërisë... Dëshën ta shuajnë lëvizjen atje. Por luftëtarët dhe anëtarët e Frontit Nacionalçlirimtar kanë ditur t'i demaskojnë ballistët në mbledhje të ndryshme në popull...»

Pas krimit masiv të Glinës në fshatrat minoritare u krijua një gjendje e nderë. Elementët reaksionarë, që vepronin sipas udhëzimeve që merrnin nga Zerva, filluan të derdhnin lot krokodili për viktimat e Glinës, dhe, duke përfituar nga atmosfera që ishte krijuar në atë kohë, kaluan në kundërsulm kundër lëvizjes nacionalçlirimtare. Në këtë fushatë të re ata nuk mund të dilnin me parulla të hapura fashiste. Dhe u përpoqën ta mbulonin gjithë veprimtarinë e tyre nën parullën falso të asnjësisë. «Ne nuk kemi interes të bashkohemi as me lëvizjen nacionalçlirimtare, as me Ballin Kombëtar», — llogotisnin poshtë e lart. — Ne duhet të qëndrojmë asnjësisë, gjersa të marrë fund lufta. Ndërkohë për t'u mbrojtur nga çetat e të dyja palëve si dhe nga vjedhësit e kusarët,

që na sulmojnë nga të gjitha anët, ne duhet të organizojmë repartet tona të armatosura, që do të jenë formacione vetëmbrojtjeje. Këto reparte do të qarkullojnë nëpër fshatrat tona e nuk do të lejojnë të hyjnë në to as forcat partizane as forcat balliste. Vetëm kështu do të mbrojmë veten dhe do të evitojmë ndonjë masakër tjetër si ajo e Glinës...» Kjo që në vija të përgjithshme teza e reaksionit në minoritet. Por ajo zbukurohej dhe i paraqitej popullit me një mijë ngjyra të tjera, sipas rrethanave konkrete. Me anë të këtyre parullave mashtruese reaksioni synonte të arrinte shumë larg. Qëllimi i tij i menjëhershëm ishte të tërhiqte popullsinë e fshatrave minoritare nga lufta e përbashkët me popullin shqiptar nën udhëheqjen e partisë. Dhe për të arritur këtë qëllim reaksioni nuk kufizohej vetëm me fjalë; ai kishte filluar prej kohe të krijonte organizata shoviniste dhe antipopullore. Këto përpjekje të tij u intensifikuan shumë pas masakrës së Glinës. Nga njëra anë reaksioni organizoi disa mbledhje të gjera me parinë e fshatrave minoritare, ku u shtrua dhe u diskutua platforma e asnjansjesisë dhe formimi i çetave të veçanta, nga ana tjetër filloi të furnizohej me armë nga komanda e Zervës, që në atë kohë e kishte bazën e tij jo shumë larg kufirit tonë. Në një letër që Jorgo Zoto, një nga krerët kryesorë të reaksionit në minoritet, i dërgonte komandave të reparteve zerviste, midis të tjerash thoshte:

«Vëllezër!

Në çdo takim që kanë patur gjer tani përfaqësuesit tanë me ju, përgjegjja juaj e vetme ishte se në përleshjen e parë me shqiptarët... ndihma juaj do të ishte e menjëhershme». Pasi përmenden

disa akte terroriste të ballistëve në fshatra minoritare, si ai i Glinës etj., letra në fjalë përfundonte: «Pas gjithë këtyre ngjarjeve dramatike, në një kohë prej tri ditësh, vëllezërit tuaj dyfish të robëruar ju drejtohen juve dhe kërkojnë ndërhyrjen e menjëhershme për shpëtimin e tyre. Në qoftë se për arësye që s'varen nga dëshira juaj, për të cilat ne jemi të sigurt se nuk është e mundur të ekzistojnë, nuk do të mundeni që të na vini në ndihmë të menjëhershme, të na dërgoni një numër të konsiderueshëm armësh dhe municionesh».

Si përgjegje të këtyre kërkesave, komanda e Zervës filloi të dërgonte mitralozë, pushkë e municione që reaksioni i vendosi në baza të ndryshme për të pajisur me to çetat reaksionare që ishin duke u krijuar.

Ishte jashtë çdo dyshimi se lufta kundër këtyre përpjekjeve të reaksionit do të ishte e ashpër dhe e vështirë. Për të bërë me vete sa më shumë njerëz reaksionarët zervistë organizuan në këtë periudhë disa mbledhje në vende të ndryshme për të shpallur platformën e tyre dinake të asnjansisë. Por partia jonë i demaskoi qëllimet e këtyre mbledhjeve në kohën e duhur dhe ato dështuan. Në këtë mënyrë në Dropullin e Poshtëm dështoi që në fillim mbledhja që donin të organizonin reaksionarët në Vanistër. Reaksionarët duke parë kundërshtimin nga ana e popullit dhe sidomos nga ana e rinisë, u përpoqën që t'i mbanin këto mbledhje në fshatra të vogla e në vende të largëta që të mos binin shumë në sy. Nga ana tjetër morën masa që të mos merrnin pjesë në këto mbledhje njerëz që shfaqnin qoftë edhe simpatinë më të vogël karshi lëvizjes nacionalçlirimtare. Megjithatë në ato për-

sëri u futën elementë prolëvizjes, që nuk ishin të gatshëm të pranonin me sy të mbyllura planet e reaksionit. Përpara kësaj gjendjeje partia do të mobilizonte të gjitha forcat që kish në këto krahina, për t'i dhënë një goditje të fortë reaksionit Zervist. Lefteri, duke zbatuar me përpikmëri vijën e Partisë, mori pjesë aktive në realizimin e këtij qëllimi dhe nuk kurseu asgjë për të demaskuar plotësisht parullat e rreme të reaksionit në fshatrat e Rrëzës e të Vurgut.

Në fund të javës së parë të gushtit të vitit 1943 u organizua mbledhja e parë në fshatin e vogël malor Kerë në Dropullin e Sipërm. Lefteri, së bashku me komandantin e çetës së Pogonit, Panajot Pannon, dhe me një grup të mirë partizanësh, erdhi atë ditë nga zona e Libohovës në Bodrishtë. Atje u informuan se në Kerë po zhvillohej një mbledhje e gjerë me përfaqësuesit e fshatrave të Dropullit të Sipërm. Lefteri dhe shokët e tij e kuptuan menjëherë se këtë mbledhje e organizonte reaksioni dhe bashkërisht vendosën që të shkonin në atë mbledhje ku sigurisht do të kishte edhe njerëz të gënjyer edhe njerëz të ndershëm, të cilët duheshin sqaruar e sjellur në rrugën e drejtë, në rrugën e Partisë, dhe nga ana tjetër t'u hidhnin planet në erë këlyshëve të Zervës. Dhe kështu bënë.

U nisën menjëherë për në Kerë, nja dy orë larg Bodrishtës. Aty nga orët e para të pasditës ata mbërritën në një korie të dendur ku ishin mbledhur përfaqësuesit e fshatrave të Dropullit të Sipërm. Mbledhjen e drejtonte Jorgo Zotcja. Nuk ishte e vështirë të kuptohej menjëherë se

organizatorët e kësaj mbledhjeje donin të krijonin një organizatë reaksionare gjoja asnjënjë, dhe të formonin disa banda të armatosura, që gjoja do të luftonin për mbrojtjen e jetës e të pasurisë së fshatarëve nga kusarët e «nga çdo armik».

Ata që drejtonin punimet e mbledhjes u shqetësuan shumë kur panë partizanët, që po i afroreshin vendit të mbledhjes. Partizanët u drejtuan nga vendi i mbledhjes dhe duke ngritur grushtin përshëndetën me thirrjen partizane: «Vdekje fashizmit!» Asnjë përgjegje. Për një çast sundoi një heshtje e plotë. Pjesëmarrësit e mbledhjes vështronin njëri-tjetrin e nuk dinin ç'të bënin. Një nga bashkëpunëtorët më të ngushtë të Jorgo Zotos ju drejtua Lefterit me këto fjalë: «A i dini ju zakonet e vendit apo i keni harruar fare? Sipas zakonisht tonë në dasmë nuk shkon njeri i paftuar». Lefteri e kuptoi menjëherë se ku e kishte fjalën këlyshi i Jorgo Zotos, dhe, me mprehtësinë që e karakterizonte iu përgjegj aty për aty: «Po, është e vërtetë, se as në dasmë, as në aheng nuk shkon njeri i paftuar. E po të shkojë aty mbetet i pandëruar dhe i turpëruar. Po ne nuk erdhëm këtu as për të kënduar e as për të kërcyer. Edhe ju nuk besoj se jeni mbledhur këtu për argëtim. Kështu pra, ne erdhëm vetëm me një qëllim: t'u themi pjesëmarrësve të kësaj mbledhjeje të vërtetën...»

Kështu filloi debati. Lefteri paraqiti qartë vijën e partisë dhe të lëvizjes nacionalçlirimtare për bashkimin e popullit e për luftën e armatosur. «Kjo është e vetmja rrugë për ne, — u tha Lefteri. — Çdo rrugë tjetër të çon në aventurë, në katas-



trofë...» Debati qe i ashpër dhe zgjati gjer afër mbrëmjes. Parullat e reaksionit u demaskuan. Planet e reaksionarëve u prishën, u sabotuan. Mbledhja, që ishte organizuar nga ata me qëllime të caktuara, nuk mori asnjë vendim. Duke folur më vonë për këtë mbledhje Lefteri thoshte: «Me njerëzit që ishin mbledhur atje s'mund të bëje asgjë. Ky qe një material që s'mund të përdorej në asnjë ndërtim. Ndaj edhe ne hodhëm një bombë në mes të tyre dhe i bëmë copë e thërrime. Ata u kthyen në shtëpinë e tyre duarbosh. Ndërsa ne atë ditë bëmë diçka: sabotuam edhe një përpjekje tjetër të reaksionit...»

Atë natë Lefteri dhe shokët e tij vazhduan rrugën dhe mbërritën në fshatin Leshnicë e Sipërme. Atje morën vesh se të nesërmen organizohej një mbledhje tjetër, më e madhe se ajo e Kerës, në fshatin e vogël Memoraq, pranë Dhivrit të Delvinës. Lefteri mbeti pak si i menduar kur dëgjoi lajmin për mbledhjen e Memoraqit. Pas pak u tha shokëve: «Këtu kemi të bëjmë me një plan të përgatitur mirë nga ana e reaksionit. Kemi kapur fillin e një rrjeti të tërë. Këto mbledhje, si ajo e sotmja ashtu si edhe ajo e nesërmja janë nyjet e këtij rrjeti të madh, që po ta ndjekësh gjer në fund të çon drejtpërdrejt në koman-dën e Zervës...»

Ditën tjetër grupi i partizanëve mblodhi disa informata të tjera për mbledhjen dhe u nis për në Memoraq, që të shkatërronte edhe njëherë planet e errëta të reaksionit.

Mbledhja e Memoraqit qe shumë më e gjerë se ajo e Kerës. Në të merrnin pjesë kryeqësitë

e fshatrave minoritare të nënprefekturave të Delvinës, Konispolit e Sarandës, bajraktarët e kapedanët e dështuar të Vurgut, mësues e intelektualë të tjerë si dhe shumë të ftuar. Një pjesë e mirë e pjesëmarrësve të mbledhjes ishin nën ndikimin e plotë të reaksionit; por kishte edhe njerëz të gënjyer, njerëz që ende s'kishin vendosur për rrugën që do të merrnin; kishte edhe disa të rinj, që simpatizonin lëvizjen nacionalçlirimtare, por kishin vajtur në këtë mbledhje, sepse nuk ishin të qartë mbi qëllimet e saj të vërteta.

Organizatorët e mbledhjes ishin po ata njerëz që kishin organizuar edhe mbledhjen e Kerës. Qëllimet ishin, sigurisht, të njëjta, po këtu u shfaqën më haptazi se në mbledhjen e mëparshme. Folësi kryesor ishte po ai Jorgo Zoto. Nga fjala e tij dilte qartë: themelimi i një organizate reaksionare për minoritetin, që nën etiketën e asnjanesisë do të bënte punën e reaksionit; dhe mbi të gjitha formimi i çetave gjoja asnjanesë, por që në të vërtetë do të vepronin sipas urdhërave të Zervës, me armët e të cilit do të armatoseshin.

Pasi mbaroi referuesi, filluan diskutimet. Çdo gjë ishte organizuar mirë nga regjizorët e fshehtë të kësaj mbledhjeje. Ata që merrnin fjalët solidarizoheshin plotësisht me referuesin dhe me deytirat që kishte parashikuar ai. Dukej se çdo gjë do të shkonte në rregull dhe mbledhja do të aprovonte projektvendimin që kishin paraqitur krerët e reaksionit... Mbledhja zhvillohej në vend të hapur, nën hijen e disa pemëve të mëdha. Aty nga dreka rojet që ishin vendosur rreth vendit të mbledhjes lajmëruan: «Po vjen Lefter Taloja

me çetën e tij». Ky lajm ra si bombë në radhët e pjesëmarrësve e sidomos të organizatorëve të saj. Ata, të shqetësuar në kulm, filluan të merren vesh për mënyrën e veprimt. Diskutimet për një çast u ndërprejnë; ndërkohë Lefteri me shokët e tij kishte hyrë në bahçen e madhe ku zhvillohej mbledhja. Për çdo të papritur ata lanë disa shokë të armatosur rreth kories dhe dy-tre shokë prej tyre vazhduan rrugën përpara.

— Nuk ju duam! Nuk ju duam! — bërtitën me të madhe disa, sipas udhëzimeve që morën nga organizatorët e mbledhjes. — Largohuni që këtej!

— Këtë vend e këtë zonë e kemi çliruar ne partizanët, me gjakun e shokëve tanë, dhe s'ka burrë që të na pengojë as edhe një grimë — ju përgjegj Lefteri me vendosmëri të plotë dhe kontrollloi xhepin për të shikuar në se e kishte në vend bombën e dorës.

— C'kërkoni këtu? Kush ju thirri në mbedhjen tonë? — vazhdonin të bërtisnin si në kor ata që ishin pasonjësit më të zellshëm të Zotos e të klikës së tij.

— Ti je tradhëtar! Se na ke vënë edhe shkabën me yllin në kapele, — i bërtiti me të madhe një nga veglat më të ndyra të reaksionit zervist.

— Ore, do të ikësh, apo të nxjerr koburen! — ju krekos me kapadaillëk njëri nga kapedanët e dështuar të Vurgut.

— Mbaje, mbaje pisqollën në brez se ka kohë që të është ndryshkur, — ju përgjegj me gjakftohtësi Lefteri duke qëndruar mu në mes të mbledhjes. — Se trimëria nuk tregohet këtu nën hi-

jen e këtyre arrave, por atje ballë për ballë me armikun. Sa për fjalën që tha ai miku yt, — dhe Lefteri u drejtua nga ai që e kishte quajtur tradhëtar, — unë vetëm një gjë mund t'i them: Tradhëtinë dhe turpin ai e ka bërë zanat prej kohe...

Një pjesë nga ata të mbledhjes ishin edhe të armatosur. Por asnjëri nuk i preku armët me dorë. Vendosmëria e Lefterit dhe e partizanëve të tjerë i kishte hutuar të gjithë. Ata e dinin mirë se Lefteri ishte trim i papërmbajtur në përlëshje me armiqtë dhe nuk i trembej syri nga asgjë. Organizatorët e mbledhjes, të zverdhur në fytyrë, ishin grumbulluar pranë trungut të trashë të arrës së madhe dhe diçka pëshpërisnin me zë të ulët. Aty përpara mbledhjes, që kishin organizuar ata, qëndronte armiku i tyre i rrezikshëm; qëndronte ai që edhe një ditë më parë u kishte hedhur planet në erë atje në korien e dendur të Kerës, dhe tani guxonte të futej në këtë fole grerëzash, pa ja bërë syri tërr. Disa nga bashkëpunëtorët e tyre propozonin që mbledhja të shpërndahej e të organizohej në ndonjë vend tjetër në mënyrë të fshehtë. Disa të tjerë bërtisnin me të madhe, që të largoheshin nga mbledhja mysafirët e paftuar. Në atë pështjellim të madh gjeti rastin Lefteri dhe ngriti zërin:

— Dëgjoni, or burra. S'është kohë për të bërtitur e për të bërë zhurmë kotsëkoti. Ne erdhëm këtu që t'ju themi fjalën tonë, fjalën e partisë. Dëgjonani një herë e pastaj flisni edhe ju...

U bë njëfarë qetësie. Lefteri përfitoi nga kjo dhe hodhi shigjetën drejtpërdrejt në shenjë...

— Më vjen keq, — vijoi ai, — që disa prej jush, i heq nga hunda Zotoja dhe bërtasin, sepse

kështu u thotë zotria e tij. Po Zotoja, bre burra, vetëm trupin ka këtu tek ne; ai kokën dhe mendjen i ka në Egjipt e në Greqi, aty ku ka dyqanet dhe fabrikat e tij. Sa për veten time s'kam për të thënë ndonjë gjë, se më njihni të gjithë. Unë kam dalë nga balta e Vurgut dhe jam rritur me misërnike, kështu si shumica e njerëzve që janë këtu. Disa prej jush thanë qëpari përse erdhëm ne këtu. Ne erdhëm që t'ju themi mendimin tonë e të marrim pastaj një vendim të drejtë. Sot vendosen fatet e popujve. Po të marrim një vendim të drejtë e të peshuar mirë do të na lavdërojnë edhe brezat e ardhshëm. Në rast të kundërt, në rast se shkelim në dërrasë të kalbur siç ju thotë Zotoja, do të na mallëkojnë edhe fëmijët edhe fëmijët e fëmijëve tanë...

Këto fjalë bënë përshtypje të madhe. Kundër atyre që bërtisnin ende: «Nuk i duam!», «Të shpurren kënde!» u dëgjuan thirrje të tjera: «Daleni, bre, t'i dëgjojmë një herë!», «E di që nuk e ka keq ky?», «Ore e ka mirë ai, nuk flet në erë...» Kështu filloi përçarja në radhët e pjesëmarrësve të mbledhjes. Lefteri foli gjatë atë ditë dhe u shpjegoi mirë e qartë qëllimet e lëvizjes nacionalçlirimtare. Pas tij folën edhe shokë të tjerë. Disa u ngritën dhe i kundërshtuan. Dhe ata folën përsëri. Ishte e qartë se mbledhja që shumë heterogjene dhe s'mund të merrte ndonjë vendim. Por qëllimi kryesor ishte arritur. Mbledhja, që ishte organizuar nga reaksioni për qëllime të caktuara, ishte hedhur në erë. Organizatorët e saj ishin demaskuar keq dhe gjer në njëfarë pike ishin izoluar. Ata në mbrëmje u grumbulluan në një shtëpi të Dhivrit dhe qanë hallin e tyre. Tani e shihnin qartë

se s'mund të merrnin dot një vendim që të ishte në kundërshtim të hapur me lëvizjen nacionalçlirimtare dhe parimet e saj. Fjala e partisë hynte gjithnjë më shumë në masat e popullit. Parulla e asnjësisë së gënjeshtërt s'mund t'i gënjente ata. Shtresa gjithnjë më të mëdha punonjësish në minoritet dhe veçanërisht nga radhët e rinisë e shikonin qartë se rruga e luftës së armatosur kundër pushtuesve dhe tradhëtarëve, nën udhëheqjen e partisë, ishte e vetmja rrugë e drejtë, ishte shpëtimi i tyre i sigurt. Prandaj reaksioni ndërroi taktikë dhe përdori manevra më dinake për të arritur objektivat që i kishin caktuar padronët e tij.

Lefteri duke zbatuar gjithnjë vijën e partisë për të demaskuar pa mëshirë reaksionarët e çdo ngjyre, nuk e pushoi asnjë minutë luftën kundër forcave reaksionare, që përpiqeshin të merrnin situatën në dorë. Krerët e reaksionit edhe pas dështimit të tyre të plotë në mbledhjet e Kerës e të Memoraqit, bënë shumë takime të tjera për të vazhduar punën e tyre përçarëse. Një ditë në vjeshtë të vitit 1943 Lefterin e informuan se në Hauret e Hustovës, pranë fshatit Dhivër, ishin mbledhur disa nga reaksionarët më në zë për të komplotuar kundër lëvizjes nacionalçlirimtare. Ai pa u vonuar mori me vete 4-5 partizanë besnikë e të vendosur dhe u nis për në Hustovë. Krerët e reaksionit ishin mbledhur në një haur të madh. Nga informatat që kishte Lefteri ata ishin që të gjithë të armatosur. Ai kontrolloi një herë mirë vendin dhe u tha partizanëve: «Duhet t'ua prishim këtë fole. T'ua hedhim planet në erë». Pastaj mori një partizan me vete dhe u tha të tjerëve: «Ju do të rrethoni haurin dhe do të jeni gati për zjarr. Unë me këtë shok

do të futemi brenda. Ata sigurisht do të habiten kur të na shohin te dera. Dhe mund të shtien kundër nesh. Se janë që të gjithë të armatosur. Po të dëgjoni pushkë, bjeruni kokës ju nga jashtë». «Po atje do të jeni edhe ju, Lefter. Si do të shtiem ne kundër haurit?» «Ore të shtini që ç'ke me të. Të qërohen një herë e mirë këta qena. Pa le të vritemi edhe ne».

Ai hyri brenda dhe ata u dorëzuan pa asnjë kundërshtim. Duke folur për këtë ngjarje në Hustovë Lefteri thoshte: «Ata u hutuan kur na panë te dera e haurit. Dhe ngritën duart menjëherë. E di sa m'u neveritën në atë çast? Ndoshta nuk do të më besoni, por unë do të dëshiroja të kishin një fije burrërie më shumë. Por atë ditë e kuptova më qartë se ata dalloheshin vetëm për një gjë: për intriga e për poshtërsi...»

Pas kapitullimit të Italisë fashiste forcat partizane që çliruan Sarandën kapën atje sasira të mëdha ushqimesh e materialesh të tjera të ushtrisë italiane. Me urdhër të shtabit të Zonës së parë operative Vlorë-Gjirokastrë u organizua transportimi i këtyre materialeve për në zona të lira, që ishin larg qendrave e rrugëve të komunikacionit. Një pjesë e tyre u dërgua në Theologo, që gjendej në thellësi të zonës së lirë të rrethit të Delvinës dhe kishte lokale të përshtatshme për depozitim të tyre. Lefteri tregoi një kujdes të veçantë për vendosjen dhe ruajtjen e këtyre materialeve që do t'u vlenin shumë më vonë forcave partizane dhe spitalit partizan që u krijua më vonë në këtë zonë. Mirëpo përqëndrimi i sasirave të mëdha ushqimesh në qendër të Theologos tërhoqi

lakminë e disa elementëve reaksionarë, plaçkaxhinj e kusarë të fshatrave të afërta. Këta elementë, duke përfitur nga rasti që forcat partizane ishin larguar për të ndaluar hyrjen e gjermanëve nga ana e Konispolit, e të shtyrë nga reaksioni, sulmuan një natë godinën ku ruheshin ushqimet dhe mallrat e tjera të ushtrisë italiane. Atje në atë kohë ishte Lefteri me tre-katër partizanë. Plaçkaxhinjtë ishin të shumtë. Ata ishin të armatosur dhe kishin sjellë me vete edhe kafshë për t'i ngarkuar me ushqime. Lefteri dhe partizanët e tjerë zunë pozicione dhe u bënë gati për luftë. Organizatori i këtij sulmi banditesk, që hiqej edhe si më trim nga të tjerët, sulmoi i pari drejt hyrjes së godinës. Lefteri i doli përpara me revolen në dorë dhe i bërtiti: «Mbrapsht! Se do ta paguash me lëkurën tënde!» Kur dëgjuan zërin e Lefterit kusarët e tjerë shtangën në vend. Kërciti pushka. Po Lefteri dhe shokët e tij nuk u tundën nga vendi. Në mëngjez kusarët u tërhoqën. Kur u kthyen nëpër fshatrat e tyre populli i vuri në lojë. Njëri nga ata kur e pyetën pse u kthye bosh u përgjegj: «Gjersa është atje Lefter Taloja ne nuk i shtiem dot në dorë magazinat...»

Ditën e kapitullimit të Italisë nga burgu i Korfuzit ishin arratisur disa qindra kuadro të Partisë Komuniste Greke, që dergjeshin aty prej një kohe të gjatë. Disa ditë më vonë në ishull zbarkuan gjermanët dhe puna e parë që donin të bënin ata ishte arrestimi i komunistëve të arratisur. E vetmja rrugë shpëtimi për ata ishte kalimi për në Greqi nëpërmjet tokës sonë. Lefteri e organizoi më së miri shpëtimin e këtyre komunistëve vete-



ranë. Ata vinin grupe-grupe me barkë nga Korfuzi, zbrisnin natën në tokën tonë në një skelë të vogël karshi Butrintit dhe së andejmi përcilleshin nëpërmjet zonës së lirë për në Greqi. Kjo punë vazhdoi disa ditë me radhë. Mirëpo zbarkimin e njerëzve nga barka që vinte përnatë nga Korfuzi e nuhatën edhe ballistët e Konispolit. Ata dyshuan se mos ishin tregëtarë kontrabandistë dhe u vajti mendja për plaçkë. Ndaj një natë zunë Shkallën e Saronesë nga do të kalonin detyrimisht ata që vinin nga Korfuzi. Atë natë kishte mbërritur kontigjenti i fundit i të burgosurve të arratisur, që përbëhej prej më se pesëdhjetë vetash. Shumë prej tyre ishin të sëmurë e të rraskapitur nga burgimi i gjatë e nga uria. Pasi hëngrën dhe u çlodhën pak në Xarë ata u nisën për të kaluar në zonën e lirë. Në atë çast vjen një çoban te Lefteri dhe i thotë se Shkalla e Saronesë ishte zënë nga ballistët. Ç'të bënte? Atje në Xarë s'mund t'i mbante ditën se vinin vazhdimisht gjermanë e ballistë. Lefteri u mendua një herë dhe pastaj e pyeti çobanin: «Sa ballistë janë?» «Janë nja njëzet veta» — ju përgjegj çobani. Dhe ai mori vendim menjëherë. Me ndihmën e atyreve që mbaheshin më mirë preu nga pylli disa degë dhe i dha secilit nga një stap që ta mbanin në krahë si pushkë. Pastaj u shpjegoi atyreve se si qëndronte puna dhe u tha: «Tani do të marshojmë përpara. Mbani mirë «dyfekun» dhe ecni serbes, si partizanë». Ai vetë u vu në krye të kolonës. Në të mugëtit e mëngjezit të vjeshtës njerëzit u vunë në lëvizje. Ballistët, kur panë prej së largu kolonën e madhe prej afro gjashtëdhjetë vetash, i morën për partizanë dhe e

braktisën vendin pa e shkrehur fare. Dhe ata kaluan lirisht për në zonën e lirë... Një nga ata të burgosurit që shpëtuan atë natë u bë më vonë komisari politik i një reparti të madh partizanësh në Greqi. Dhe sa herë e sillte rasti fliste me admirim dhe mirënjohje të thellë për Shqipërinë mikpritëse dhe për Partinë Komuniste Shqiptare që kishte rritur dhe edukuar revolucionarë të patrembur, që dinin të venin në rrezik edhe jetën e tyre për të shpëtuar shokët...

Në vjeshtë të vitit 1943 Lefteri u kthye përsëri në rreshtat e Batalionit «Thoma Lula» prej nga ishte transferuar para 3-4 muajve me urdhër të Komitetit qarkor të partisë për Gjirokastrën. Ky batalion gjatë luftimeve frontale kundër gjermanëve në zonën e Konispolit, që kishin vazhduar afro dy muaj, kishte pësuar mjaft humbje në njerëz, por që forcuar e kalitur në përleshje të ashpra dhe ishte gati tani të ndërmernte beteja edhe më të mëdha edhe më të vështira. Ashtu si kudo në Shqipëri, edhe në krahinën e Delvinës e të Konispolit bashkëpunimi i Ballit me armikun bëhej gjithnjë më i hapur. Shoku Enver në letrën drejtuar Komitetit qarkor të Partisë për Gjirokastrën, në lidhje me qëndrimin kundrejt «Ballit Kombëtar», «Legalitetit» dhe misionëve ushtarake angleze, më 1 tetor 1943 shkruante: «S'ka më bashkim me «Ballin», e zhdukni këtë iluzion, dhe as kemi ndonjë fitim për t'ja arritur kësaj pune. Me një organizatë që ka në shpirt kompromisin, që s'ka hedhur asnjë pushkë kundër fashizmit dhe që vazhdon të mos hedhë asnjë kundër gjermanëve, por i ndihmon këta për të na vrarë, me një organizatë që gjithë aktivite-

tin e saj e ka drejtuar kundër lëvizjes sonë, kundër komunizmit dhe Partisë Komuniste, s'kemi se si bëjmë bashkim...»

Nuk është aspak një koincidençë e rastit që po në atë kohë, në vjeshtë të vitit 1943, edhe krerët e reaksionit në minoritet që i bashkërendonin veprimet e tyre me Ballin kaluan në sulm të hapur kundër lëvizjes nacionalçlirimtare. Në këtë mënyrë gjatë muajve tetor e nëntor lufta midis forcave partizane dhe atyre reaksionare arriti kulmin. Në atë kohë banda që komandohej nga reaksionari me damkë Kristo Pilo, e që gjer në atë kohë hante pulat e bridhte bostaneve në fshatrat e Vurgut, bëri një diversion në thellësi të zonës së lirë drejt fshatrave Leshnicë e Poshtme dhe Leshnicë e Sipërme. Në këtë diversion me çetën famëkeqe të sipërpërmendur ishin bashkuar thujtë të gjithë krerët e reaksionit në minoritet dhe lloj-lloj aventurierësh dhe dallkawkësh me patentë. Kur mbërritën në Leshnicë të Sipërme ata rrethuan fshatin me forcat e tyre, vendosën një mitraloz të rëndë në qendër për frikësim dhe nisën nga presionet për t'i detyruar fshatarët të merrnin anën e tyre. Rinia e Leshnicës, ndonse fshati që i rrethuar, gjeti mënyrën dhe lajmëroi Batalionin «Thoma Lula», mbi sa ndodhnin aty. Në atë kohë në Batalionin «Thoma Lula» ndodhej edhe komunisti veteran Mustafa Matohiti. Lefter Taloja, që e njih-te mirë gjendjen në minoritet, i shpjegoi Mustafait se si qëndronte puna dhe me ç'njerëz kishin të bënin. Menjëherë u muarr vendimi që batalioni të shkonte në vend e t'i çarmatoste forcat bashi-bozuke të reaksionit. Ndokush mund të mendonte

se do të pëlciste ndonjë luftë e rreptë midis forca-  
ve të reaksionit dhe batalionit partizan «Thoma  
Lula». Por nuk ndodhi asgjë e tillë. Bukuroshët  
e çetës së Kristo Pilos, që krekoseshin si gjela  
përpara burrave të paarmatosur të fshatit, u bënë  
menjëherë si pula të lagura kur panë partizanët  
e batalionit, që kishin ngrënë barutin me grusht  
në beteja të njëpasnjëshme kundër pushtuesve ita-  
lianë e gjermanë. Pa hedhur asnjë pushkë banda  
e Kristo Pilos dorëzoi armët dhe qysh atë ditë  
u shpërnda. Kështu dështuan edhe njëherë nga ana  
ushtarake përpjekjet e çmendura të reaksionit për  
të formuar në minoritet çeta të armatosura kun-  
dër lëvizjes nacionalçlirimtare dhe në kundër-  
shtim me vullnetin e masave punonjëse.

Mustafai dhe Lefteri folën në një mbledhje  
të përgjithshme të popullit dhe demaskuan qëlli-  
met antipopullore të reaksionarëve të kallëpit të  
Kristo Pilos. Pastaj njerëzit e thjeshtë të bandës  
së çarmatosur u lanë të lirë për të shkuar në shtë-  
pitë e tyre. Krerët e bandës i mbajtën dhe ditën  
tjetër në fshatin Dhrovjan u zhvillua gjyqi kun-  
dër tyre. Aty Mustafai përpara popullit dhe parti-  
zanëve drejtoi tehun e demaskimit kundër Jorgo  
Zotos, që synonte të luante rolin e kryetarit të  
reaksionit në fshatrat minoritare të asaj zone. Lef-  
teri nga ana e tij, që u njihte dhëmbë e dhëmballë  
këtyre sharlatanëve dhe që kishte luftuar edhe  
në raste të tjera gjoks më gjoks kundër tyre duke  
mbrojtur vijën e Partisë, dha një kontribut jo të  
vogël në shpartallimin dhe demaskimin e tyre  
përfundimtar. Pas atij gjyqi krerët reaksionar të  
dështuar, por të kënaqur që shpëtuan lëkurën, fi-

lluan të arratisen një nga një për në Greqi, sepse e shihnin qartë se këtu nuk i mbante më vendi. Kjo nuk do të thoshte aspak se lufta kundër reaksionit në minoritet kishte marrë fund. Ajo vazhdoi edhe më vonë me forma e mënyra të tjera...

Në fillim të nëntorit 1943 Batalioni «Thoma Lula» mori urdhër nga shtabi i Zonës I operative Vlorë-Gjirokastër që të lëvizte nga zona e lirë Delvinë-Konispol dhe së bashku me forca të tjera partizane të çlironte nga forcat balliste Libohovën. Pas një lufte të ashpër në afërsi të Libohovës dhe nëpër lagjet e qytetit, forcat balliste, që ishin shumë më të mëdha në numër u shpartalluan dhe u vunë në ikje. Në këto luftime të ashpra Lefteri, si gjithnjë, u dallua për trimëri dhe iniciativë.

Pas luftës së Libohovës dhe pastrimit të terrenit nga mbeturinat balliste, ndërsa forcat e tjera partizane u drejtuan për në qytetin e Gjirokastrës, Batalioni «Thoma Lula» mori urdhër që të ndiqte forcat balliste që ishin grumbulluar në krahinën e Këlcyrës. Në këtë operacion të madh, Lefteri u dallua jo vetëm si luftëtar i vijës së parë, por edhe si agjikator e propagandist i flaktë i vijës së partisë, në një zonë që për një kohë të gjatë kishte qenë nën sundimin e Ballit Kombëtar. Si bir fshatari që ishte Lefteri dinte t'u afrohej fshatarëve, t'u fliste gjuhën e tyre e t'u hynte menjëherë në zemër. Në këtë kohë Lefteri u emërua përkohësisht komisar i batalionit territorial të Kurveleshit, me të cilin vazhdoi luftimet në drejtim të Sukës dhe të Qafës së Kiqokut. Në ditarin e tij një nga partizanët e Batalionit «Thoma Lula» lidhur me luftimet në zonën e Këlcyrës shkruan:

«Pas shpartallimit të tyre të plotë krerët e Ballit të krahinës së Këlcyrës kërkuan ndihmën e gjermanëve. Atëhere u nisën nga Beratit forca të shumta gjermano-balliste me mjete të mekanizuara (tanke dhe autoblanda) dhe na sulmuan në Qafën e Këçokut... Armiku kërkonte me çdo kusht të na thyente e të na kalonte për në Këlcyrë. Por forcat tona me sulme e kundërsulme nuk i lanë të realizonin planin e tyre... Ne vazhduam pastrimin e krejt krahinës nga bandat e tradhëtarit Ali Këlcyra, duke bërë një punë të mirë sqaropnjëse ndërmjet fshatarëve e duke bërë diferencim midis elementëve të mashtruar dhe tradhëtarëve të shitur kokë e këmbë te armiku... Në fund të dhjetorit na u kthye përsëri në batalion Lefter Taloja, që kishte vajtur për një kohë si komisar i batalionit territorial të Labërisë... Ne e pritëm me gëzim kthimin e tij... Ai është i dashur me të gjithë shokët dhe kujdeset shumë për hallet dhe shëndetin e partizanëve. Megjithëse nuk e kemi në kompaninë tonë, e thërrasim shpeshherë që të na flasi për gjëra që ne nuk i dimë. Ai, po të mos jetë i zënë me ndonjë punë tjetër, vjen menjëherë. Dhe sa bukur flet! Ke kënaqësi ta dëgjosh...»

Në ditët e fundit të vitit 1943 Batalioni «Thoma Lula» pas shumë luftimesh e fitoresh kundër gjermano-ballistëve u kthye në zonën e lirë Delvinë-Konispol, ku vepronte më parë. Në atë kohë komandanti i batalionit Haki Rushiti kaloi në tradhëti të hapur dhe u bashkua me armikun. Lefteri i kishte kundërshtuar që në ditët e para të krijimit të Çetës «Çamëria», të gjitha veprimet

arbitrare të këtij komandanti megalloman e kapadai. Disa herë me radhë i kishte raportuar edhe komitetit qarkor të partisë për sjelljet e Haki Rushitit që nuk përputheshin me cilësitë e komandantit të një ushtrie thellësisht popullore, siç ishte që në fillim Ushtria Nacionalçlirimtare. Shumë herë Lefteri e kishte kritikuar atë hapur përpara gjithë çetës e gjithë batalionit. Prandaj ai, si komandant që ishte, kishte dashur të hakmerrej kundër Lefterit. Po Lefteri ishte bir i popullit. Ndërsa ai që shpifte e intrigonte kundër tij përfundoi në baltën e turpit e të tradhëtisë...

Në ato ditë të stuhishme në fillim të janarit të vitit 1944, kur armiku sulmonte me forca të mëdha nga të gjitha anët, erdhi urdhëri nga Shtabi i Përgjithshëm për të nisur një kontigjent partizanësh të zgjedhur e të sprovuar të batalionit për në Brigadën VI, që ishte në formim e sipër. Lefteri shprehu dëshirën që të shkonte edhe vetë në Brigadën VI. Kërkesa e tij u pranua dhe nga mesi i janarit u nis si komisar i repartit që dërgohej në brigadën e re.

Brigada VI, që do të formohej në qytetin e lirë të Përmetit, u inaugurua në luftime të ashpra kundër gjermanëve, që kishin nisur operacionin e dimrit. Partizanët e Batalionit «Thoma Lulla», pas një rruge të gjatë prej dy ditësh, mbërritën në Përmet natën vonë. Pa pushuar asnjë minutë morën urdhër të lëviznin menjëherë e të zinin pozicione së bashku me forcat e tjera, për të ndaluar hyrjen e forcave gjermane, që vinin nga ana e Kolonjës. Në luftimet e ashpra që vazhduan disa ditë Lefteri u dallua edhe një herë si luf-

tëtar i patrembur dhe me iniciativë në çdo situatë e në çdo rrethanë.

Me organizimin e forcave të Brigadës VI partizanët që kishin ardhur nga Batalioni «Thoma Lula» formuan një kompani të veçantë në batalionin e katërt të kësaj brigade, që quhej Batalioni «Naim Frashëri». Komisar i kësaj kompanie u caktua Lefteri.

Dashnor Mamaqi, ish-komisar i këtij batalioni, thotë: «Lefteri ishte një shok i formuar dhe i vendosur. Që në ditët e para të formimit të brigadës sonë ai u caktua edhe përgjegjës i punës kulturele e arësimore në gjithë batalionin. Dhe këtë punë e kryente me zell të madh. Një interesim të veçantë tregonte për t'u mësuar shkrim e këndim partizanëve analfabetë. Kur s'kishim luftime dhe hynim në ndonjë fshat, punë e parë e Lefterit ishte që të pyeste nëse kishte aty shkollë. Dhe po të kishte shkollë i mblidhte të gjithë analfabetët në klasë dhe u bënte mësim. Shumë herë mësimin me analfabetët e bënte edhe jashtë, por i pëlqente të gjente një klasë me banka e dërrasë të zezë, që të zhvillonte një mësim të rregullt...»

Bashkë me forcat e Brigadës VI Lefteri mori pjesë në të gjitha luftimet që zhvilloi kjo brigadë gjatë ditëve të vështira të Operacionit armik të dimrit. Pas mbarimit të operacionit brigada u hodh në kundërsulm dhe përshkoi gjithë zonën e Mallokastrës. Ylvi Lulo, ish-zëvendëskomisar i kompanisë në të cilën Lefteri ishte komisar, lidhur me jetën dhe luftën e Lefterit në atë fazë të fundit të jetës së tij pas Operacionit të dimrit, tregon: «Operacioni i dimrit mbaroi, por ai la prapa shka-





Një grup partizanësh të batalionit «Naim Frashëri».

tërrime e dëme të panumërta. Ne, duke ndjekur këmba-këmbës armikun, u futëm thellë në zonën e Mallakastrës. Atje shikonim shtëpitë e djegura dhe fshatra të shkatërruara e të shkretuara. Një urrej-tje e madhe na ndizej në shpirt kundër armikut gjakatar... Kur sjell ndër mend ato ditë të vësh-tira, më kujtohet menjëherë Lefter Taloja. Ç'të them më parë për Lefterin? Unë atë e njihja edhe më parë, se për një kohë të gjatë kemi qenë bash-kë në Batalionin «Thoma Lula». Por në Brigadën VI e njoha edhe më mirë. Ne ishim në një kom-pani; ai komisar, unë zëvendëskomisar. Kështu bashkë punonim, bashkë luftonim... Ai ishte djalë i popullit dhe kishte një zemër të pastër si po-pulli. Lefteri ka pasur cilësi të rralla. Ai ka qenë edhe luftëtar i patrembur, edhe agjikator i flaktë, edhe shok i mirë e i dashur. Mua kurrë nuk do të më harrohet ajo ditë e largët e 29 marsit 1944, kur ai dha jetën në ballë të luftës kundër armikut. Lufta kundër kalasë së Margëlleçit, mbi Patosin, ka qenë një nga luftërat më të ashpra, që ka zhvilluar batalioni ynë. Natën e mëparshme ki-shim fjetur së bashku me Lefterin në një shtëpi. Atij i dhimbte një dhëmballë dhe thujtja s'hën-gri fare. Në mesnatë u nisëm për të sulmuar ka-lanë, që ngrihej mbi kodrat e tjera përreth. Ishte ende errësirë, qielli që i vrenjtur dhe nuk shih-nim as hundën tonë. Toka ishte e lagur dhe herë-herë zhytshim gjer në gju në baltë. Lefteri, që shkonte përpara, shkau në një vend, dhe u rrë-zua. Por u ngrit menjëherë dhe vazhdoi rrugën. «U vrave, Lefter?» — e pyeta. «Jo, nuk u vrava hiç; po më vjen keq që m'u zhubros e m'u bë me bal-

të kostumi» — m'u përgjegj me shaka. Në të aguar filluam sulmin. Në kala kishte shumë më tepër forca gjermane e balliste, nga ç'mendonim ne. Kompanitë e batalionit tonë morën drejtime të ndryshme për ta rrethuar kalanë nga të gjitha anët. Bashkë me ne ishte edhe komisari i brigadës Mustafa Matohiti dhe komandanti i batalionit Meleq Gosnishti. Gjermanët na pikasën shpejt dhe filluan të shtijnë kundër nesh me të gjitha llojet e armëve: me topa, mortaja, mitralozë e automatikë. Kompania jonë sulmonte në një vend shumë të pjerrët. Gjylet e topave e të mortajave shpërthenin pranë nesh. Lefteri, duke sulmuar përpara nja dy hapa larg meje, bënte herë-herë shaka: «Ylvi! — më thërriste mua, — ç'janë këto që bien kësh-tu, domate apo patate?!» — dhe vazhdonte sulmin në mes të breshërit të plumbave duke shkuar gjithnjë përpara. Në një çast Lefteri qëndroi. «Ç'ke, Lefter?» — e pyeta me shqetësim. «U plagosa, Ylvi» — m'u përgjegj ai dhe shtoi: «S'është gjë, pak këtu në dorë». Unë u zvarrita drejt tij. Nga dora e majtë i rridhte gjak. Automatiku i qe skukur nga gjaku. Unë nxora nga xhepi i kapotës një fasho, që e mbaja gjithnjë me vete dhe i lidha dorën. Dhe ai u hodh përsëri në sulm. . .»

Përleshja qe jashtëzakonisht e ashpër. Armiku rezistonte me ngulm. Partizanët sulmonin me vrull të papërmbajtur. Plumbat e armikut vërshëllenin nga të gjitha anët. Lefteri, megjithëse i plagosur në dorë, shkante në krye të kompanisë, ashtu si shkante në krye të brigadës komisari i saj Mustafa Matohiti. Në çastin që partizanët u qenë afruar shumë vijave të armikut, një plumb e goditi Lef-

terin në ballë. Dhe ai ra përnjëherësh në tokën e vaditur me gjakun e shokëve.

Kështu dha jetën Lefteri, ky luftëtar i paepur për çështjen e madhe të popullit e të Partisë.

Gazeta «Zëri i popullit» me dt. 29.III.1969, njëzetepesë vjet pas sulmit të batalionit të katërt të Brigadës VI mbi kalanë e Margëllecit, në një artikull me titull «Heroi i Popullit Matohiti dhe dëshmorët e tjerë të Patosit» midis të tjerave shkruante: «Këtu në Patos ra edhe komisari i kompanisë së katërt të batalionit të katërt Lefter Talo, gjithë jeta e të cilit është jeta e një komunisti të guximshëm revolucionar. Agjitator i zoti i vijës së Partisë, njeri i ndershëm e i besës, i dashur me popullin dhe i ashpër me armiqtë, Lefteri, si komunist i flaktë, duke zbatuar porositë e Partisë, dha një kontribut të veçantë në ngritjen e popullit të Vurgut në Luftën nacionalçlirimtare të popullit shqiptar dhe në shpartallimin e reaksionit shovinist grek në atë krahinë. Ai qëndroi deri në fund të jetës së tij anëtar i denjë i Partisë Komuniste Shqiptare».

Me propozimin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH Presidiumi i Kuvendit Popullor i Republikës popullore të Shqipërisë me dt. 24.XI.1969 i dha Lefter Talos titullin «Hero i Popullit», me këtë motivacion:

«Për kontributin e madh që ka dhënë në propagandimin e vijës së Partisë dhe për mobilizimin e popullit të Vurgut të Sarandës në Luftën nacionalçlirimtare. Duke zbatuar mësimet e Partisë luftoi me vendosmëri kundër shovinistëve grekë, okupatorëve italo-gjermanë dhe tradhëtarëve të tje-

rë të vendit. Për merita të veçanta si komunist, partizan e komisar trim derisa ra heroikisht në luftë».

### «DJALË I POPULLIT, LEFTERI!..»

Lefteri u vra në fund të marsit të vitit 1944. Lajmi i zi u përhap në fshatrat e Vurgut në ditët e para të prillit. Unë në ato ditë isha larguar për një kohë nga zona e Theologos. Vdekjen e tij e mora vesh në Sheper të Zagorisë. Aty nga fundi i prillit, apo në fillim të majit po kthehesha përsëri për në Theologo. Rugës u takova me një partizan, korrier të Batalionit «Thanas Ziko», dhe udhëtonim së bashku. Ishte një ditë e bukur dhe e freskët pranvere. Gjethi kishte çelur kudo. Pllajat e maleve bleronin për bukuri. Në zonën e lirë, pas kalimit të rrebeshit të operacionit gjerman, kishte një qetësi të plotë.

Pasi kaluam Leshnicën e Poshtme, qëndruam mbi një shkëmb të madh, që të çlodheshim. Posh-të, te përroi i thellë, i veshur me rrepe shekullore, shushurinte uji, që vinte nga gurra e Leshnicës. Përkarshi nesh, nga ana tjetër e përroit, faqja e malit ishte mbuluar nga një korie e dendur lisash e lajthish. Ndërsa ishim duke biseduar dëgjuam si prej së largu një zë vajze që këndonte. Si duket vajza zbriste teposhtë kories, se zëri i saj dëgjohej gjithnjë më afër, gjithnjë më mirë. Melodia e këngës ishte e njohur, kurse fjalët i dëgjonim për herë të parë. U shikuam një herë me shokun, sikur

të donim të pyesnim njëri-tjetrin: «Ç'është kjo këngë e re?» Në atë çast në një lirishte të vogël në mes të pyllit pamë një vajzë fshatare nja dhjetë-dymbëdhjetë vjeçe, që kulloste kecërit duke kënduar. Ne e shihnim mirë vajzën e vogël, ndërsa ajo s'na kishte vënë re fare. Në një çast vajza qëndroi, përkuli një degë lisi me gjethe të njoma duke ndjellur kecërit që të hanin. Kecërit vajtën pranë dhe ajo vazhdoi këngën:

*«O ju male që e rrethoni,  
o ju pllaja që e mbani,  
Për Lefterin trim të rrallë  
këngë trimash të këndon  
Thojini Lefterit tonë:  
Shokët trima partizanë  
Çdo pëllëmbë të vendit tonë  
me gjakun e tyre e lanë.*

— Ore, kjo sikur këndon këngën e Lefterit,  
-- më tha partizani.

— Pse, ka dalë ndonjë këngë për Lefterin?  
— u habita unë.

— Kështu kam dëgjuar; por unë s'e di, se kam qenë vazhdimisht në lëvizje.

Vajza, kur dëgjoi zërat tanë, ktheu kokën me habi dhe na tha duke qeshur:

— Oj! Si nuk e dini ju këngën e Lefterit?

Ne, sikur të ishim marrë vesh midis nesh prej kohe, u hodhëm në këmbë, kapërcyem përroin dhe u drejtuam nga vajza. Kecërit u trembën dhe u larguan, kurse ajo erdhi drejt nesh.

— Hajde na i mëso këtë këngë tani, — i thamë ne.

Dhe atje në atë lirishte të qetë, ndërsa dielli i pranverës rrëshqiste drejt perëndimit, vajza na mësoi këngën e re. Në fund e kënduam që të tre së bashku. Pastaj vajza ndolli keçërit dhe u largua. Unë e vështroja ndërsa ajo humbiste në mes të shkurreve dhe mëndohesha. «Lefteri vdiq por ai rron në zemrën e popullit. Dhe populli i nxori këngë, si monument të parë në kujtim të tij. Kënga ka marrë dhenë menjëherë, ashtu si fjalët e tij, si trimëritë e tij».

Duke vazhduar rrugën për në Theologo thoshja me vete «Sa herë kemi kaluar së bashku këtyre monopateve malore e këtyre gërxheve! Herë-herë ecnim në heshtje duke ëndërruar për të ardhmen, herë-herë bisedonim për problemet e ditës...» Dhe m'u kujtua takimi im i fundit me Lefterin. Kishin kaluar qysh atëhere më shumë së tre muaj. Ishte një ditë dimri, 17 janari, në mos gabohem. Lefteri bëhej gati që të nisej për në Brigadën VI. Në Dhivër atë ditë organizohej një mbledhje me arësimitarët e rrethit. Qëllimi i mbledhjes ishte hapja e shkollave në të gjitha fshatrat e zonës së lirë. Pushteti i ri, i dalë nga gjiri i popullit, në mes të zjarrit të luftës së egër, interesohej që t'u jepte dritën e arësimit fëmijëve të popullit.

Mbledhja zhvillohej jashtë, në një vend të mbrojtur nga era. Lefteri, si arësimitar që ishte, erdhi vetë në mbledhje dhe punimet e saj i ndoqi me interesim të madh gjer në fund. Kur po largoheshim nga vendi i mbledhjes më tha:

«Nuk e di përse e ndjej veten shumë të mallëngjyer sot. M'u kujtua jeta ime si mësues,

fëmijët e vegjël... E di, njeriu ardhjen e pranverës e parandjen që nga muaji shkurt, kur rrëzë shkurreve e kaçubeve çelin lulet e para pak si të ndrojtura. Sa më gëzojnë këto lule, që parajmërojnë ardhjen e pranverës. Edhe kjo mbledhje e sotme si një lule e tillë ka qenë; pranvera e fitores së madhe po afrohet. Kur të marrë fund lufta do të kërkoj të bëhem përsëri mësues...»

Në mbrëmje vajtëm në një shtëpi të varfër të Dhivrit. Unë kisha qejf për muhabet, ndërsa Lefteri donte të flinte.

«Unë jam tamam fshatar, — më tha. — Në mbrëmje dua të fle herët që të ngrihem në mëngjez pa u gdhirë mirë».

Fjetëm në një dyshek, aty pranë zjarrit. Sa vuri kokën në jastëk e zuri menjëherë gjumi. Në mëngjez më ngriti që me natë. U pregatit shpejt e shpejt që të shkonte për në Leshnicë, prej nga do të nisej për në Brigadën VI. Te shkallët e shtëpisë u përqaftua. Lefteri mori tatëpjetën me hap të nxituara. Te kthesa e rrugës ktheu edhe një herë kokën e na përshëndeti me dorë. Sikur ta dinte se nuk do të shiheshim më!...

Disa javë më vonë në një fshat të vogël po hynin duke kënduar partizanët e një reparti të porsakrijuar. Fëmijët vrapuan drejt partizanëve duke thirrur të gëzuar:

— Po vjen Lefter Taloja! Po vjen Lefter Taloja!

Një grua plakë, që rrinte te dera e shtëpisë, u habit kur dëgjoi këto fjalë dhe u tha fëmijëve: «Ç'thoni kështu, or djema? Lefteri është vra-



rë». «Është Batalioni «Lefter Talo», moj gjyshe, jo vetë Lefteri» — ju përgjegj një nga fëmijët.

Partizanët kaluan nëpër rrugët e fshatit duke kënduar. Njerëzit dolën nëpër rrugët, ashtu si bënin gjithnjë, kur hynin në fshat partizanë. Përpara tyre kalon kompania e parë, e dyta, e treta... Ata nuk janë as dhjetë as njëzet. Janë më se njëqind e pesëdhjetë. Një batalion i tërë, që mban emrin e Lefter Tallos. Edhe një herë po vihej në jetë fjala e partisë: «Një bie me qindra të tjerë ngrihen...»

Pas shumë vjetësh hyra një ditë në një dhomë të vogël. Një heshtje e thellë sundonte atje brenda. Heshtja mbretëron në të gjitha muzeumet dhe aq më tepër në një dhomë muze fshati. Atje janë mbledhur shumë gjëra personale të Lefterit! Fotografi, veshje, libra, fletore. Po unë qëndroj për një kohë të gjatë përpara një tavoline të vogël e s'më bën zemra të largohem andej. Mbi tavolinë janë dy bomba dore dhe një violinë. Këto bomba janë gjetur në çantën e Lefterit ditën që u vra. Ai s'arrijti që t'i vërviste mbi armiqtë. Violina qëndron atje e heshtur. Ajo vende-vende duket si e prishur nga koha. Për një çast më duket se nga violina del një melodi, pastaj një tjetër e një tjetër. «Violina e Lefterit, — thashë me vete. — Sa herë e kam parë Lefterin me harkun e violinës në dorë! Para se të ngjesh-te pushkën në krahë, sigurisht. Me këtë violinë ai luante valle popullore që të kërcenin fshatarët. Me këtë violinë ai u mësonte fëmijëve në shkollë e në ekskursione, që organizonte me ta, këngë re-

volucionare. Me këtë violinë ai këndonte «Internacionalen», që i pëlqente aq shumë. . .

## BISEDA IME E FUNDIT ME LEFTERIN

Sa herë kaloj Qafën e Gjashtës për në Sarandë, ngrihem pak nga vendi, hedh një shikim jashtë nga dritarja e maqinës dhe përkuil një çikë kokën sikur dua të përshëndes një shok të vjetër, që gjendet diku pranë. Pastaj mbyll për një çast sytë dhe pyes veten: «A mjafton, vallë, me kaq? Vetëm me një përshëndetje prej së largu? A nuk duhet diçka më shumë, diçka më e ngrohtë për shokun tënd të rinisë, që s'është më midis të gjallëve? Më vjen për një çast dëshira që t'ja marrë këngës me zë të ulët:

*«O ju male që e rrethoni,  
o ju pllaja që e mbani...»*

Mirëpo largësia gjer në Sarandë është fare e vogël dhe në këto e sipër maqina ndalet në qendër të qytetit. Aty takohem me miq të vjetër e të rinj dhe përshtypjet e reja të jetës. sikur duan t'i mbulojnë apo t'i shtyjnë diku thellë kujtimet e vjetra. . .

Në dhjetorin e vitit 1968 kalova edhe një herë Qafën e Gjashtës. Dhe u ngrita përsëri nga vendi e përkula kokën më tepër se zakonisht. Këtë radhë shkoja në qytetin bregdetar me një grup shokësh për të bërë historikun e rrethit. . .

Ditën tjetër filluam nga puna. Mbi një tavo-

linë të madhe të një zyre të vogël në Komitetin e partisë për rrethin shtrihen komunikata, qar-kore, udhëzime, ditare dhe kujtime luftëtarësh të Luftës nacionalçlirimtare. Duke shfletuar këto letra e këto dokumenta më dukej sikur ringjalleshin edhe ata që kishin rënë në fushën e betejës. Dhe midis tyre më shfaqej orë e çast Lefteri, me pushkën në krah e me gjerdanin e ngjeshur në mes ashtu siç ishte partizan.

Një ditë të kthjellët e të ftohtë dimri u nisa nga pasditja për në Qafën e Gjashtës, ku janë varrezat e dëshmorëve. Shkoja si anës së rrugës që të mos hasja ndonjë të njohur, se dëshiroja të isha vetë. «Kushedi — thoshja me vete, — ndoshta do të ketë për të më thënë ndonjë fjalë».

Mbërrita në varrezat. Selvitë e drejta dhe portokallet tufshake, që ka mbjellur rinia e Sarandës rreth varrezave bleronin për bukuri dhe i jepnin një hijeshi këtij pejsazhi dikur të murmë e të zhveshur mbi qytetin e bukur bregdetar. Hapa derën e madhe të hekurt të varrezave dhe hyra brenda. Një heshtje e thellë mbretëronte rreth e rrotull. As shushurima e detit të xhevahirtë të gjirit të Sarandës, as zhurma e qytetit nuk arrinte gjer këtu lart. Herë-herë ndjehej për një çast, fërshëllima e lehtë e majave të selvive, që përkuleshin lehtë-lehtë sikur donin të bisedonin mi-dis tyre...

— Mirë mbrëma Lefter! — belbëzova unë dhe u përula ngadalë mbi gurin e bardhë të varrit.

Asnjë përgjegje. Edhe fërshëllima e lehtë e selvive sikur pushoi në atë çast. «Mos është gjëkafshë i zemëruar me mua?» — thashë me vete dhe

njëmijë mendime e kujtime më kaluan nga mendja. Në krye të varrit shoh një fotografi. Fotografia e Lefterit. Për një çast m'u duk sikur më buzëqeshi pak.

«Të kujtohet? — i pëshpërita. — Përpara tri-dhjetë vjetësh këtu jemi ndarë. Ishte në të ngrysur si tani. Ti u nise për në Dropullin e Sipërm, ku të prisnin nxënësit e tu. «Rri këtu sonte, Lefter, — të thamë ne, — se rruga është e gjatë dhe ke për të kapërcyer një mal të lartë. Përse të udhëtosh natën?» Po ti më shtrëngove dorën e më the: «Ne duhet të mësohemi të ecim në malet tona edhe ditën edhe natën...» Po Lefter, kështu më the. Një fjalë të madhe ke thënë atë ditë. S'kaluan dy-tre vjet dhe malet tona u mbushën me partizanë. Dhe një nga të parët ishe edhe ti...»

Prapa kodrës së zhveshur u dëgjua zhurma e një traktori. Siç duket traktori punonte prej kohe atje po tani që u fashitën zhurmat e tjera ai dëgjohej më mirë.

«E dëgjon Lefter? — i thashë me zë që më dridhej. — Traktori punon për të hapur toka të reja. Këtu lart në male. Që të bëhen edhe malet si fushat. Kështu thotë partia. Poshtë në fushë, në Vurgun tënd, që e ke pasur gjithnjë në zemër, jo vetëm që s'ka mbetur asnjë gjurmë nga kënetat e dikurshme por s'ka mbetur asnjë pëllëmbë tokë e papunuar. Ja ku e ke fushën. Shihe edhe vetë!

Po ngrysej. Befas u ndezën dritat. Drita të shumta, të panumërta. Një det dritash më i madh se vetë deti! Drita në qytet, drita edhe në fshatra. Në fshatra të vogla e të mëdha, në fshatra mallore e fushore. Dhe kështu si u ndezën të gjitha

përnjëherësh, më dukej sikur kishte më shumë drita në tokë, se sa yje në qiell.

Vë dorën në xhep dhe nxjerr një fletore të zverdhur nga koha. Është ditari i Lefterit. Këtu shënonte përshtypjet e tij nga jeta, idetë e tij, dëshirat dhe ëndërrat... Faqja që më del përpara ka datën 25 korrik 1936, domethënë është shkruar tridhjetë e tre vjet më parë. «Unë jam legjenda e Bisticës» lexoj në fletoren e tij. «Ç'farëdo?» «Po vihem në dispozicion të njerëzve», — m'u përgjegj, — «Që të bëni ç'të doni me mua, të ndërtoni edhe digë hidrocentrali po të doni: ja, aty më poshtë te fshati Krongj, nga kalove ti qëpari. E kam fjalën për atë digë, që ti e ke gjithnjë në mendje... Me anë të kësaj dige do të elektrifikohen Saranda, Delvina, Gjirokastra, fshatrat e Dropullit, Dhivri, Dhrovjani etj.»

Po Lefter! Të gjitha këto janë realizuar. Këtu rreth e rrotull janë elektrifikuar edhe Dropulli, edhe Vurgu, edhe Bregdeti. Brenda dy vjetëve nuk do të ketë fshat në Shqipëri, nuk do të ketë shtëpi në këtë vend të zhytur më parë në errësirë, që të mos ketë dritë elektrike. Dritë! Kështu thotë partia. Dhe çdo gjë që thotë partia... Ti e di vetë. Është gjë e madhe kjo Lefter! Shumë e madhe! Si thua ti?

Po ëndrra e Lefterit nuk mbaron me kaq dhe unë lexoj në fletoren e zverdhur nga koha: «Pas-taj vjen bonifikimi i fushës së Vurgut, mekanika bujqësore, ngritja e digave në breg të detit, atje te liqeni i Butrintit për të ndaluar baticën; po ka edhe më; pas tyre vjen hapja e rrugëve, ndërtimi i urave dhe i hekurudhave; vjen puna e madhe

për ndërtimin e shtëpive të bukura e të shëndetshme për fshatarët, vjen radha për kaq e kaq gjëra të tjera, që Vurgu të bëhet një kopsht i vërtetë...»

Këto gjëra ëndërroje ti Lefter, para tridhjetë e ca vjetëve, kur sapo kishe mbushur njëzet e tre vjeç. Dhe të gjitha këto, Lefter, janë bërë tani realitet. Po sa do të bëhen ende këtu tek ne! Çfarë mrekullira bëri populli ynë brenda këtyre njëzet e pesë vjetëve nën udhëheqjen e partisë! Dhe sa do të bëjë në të ardhmen!..

Atëhere ndjeva si një zë të njohur, që më tingëlloi në vesh: «Mirë e keni, shokë. Vazhdoni edhe më. Marshoni përpara, gjithnjë përpara, në rrugën e partisë. Bashkë me ju marshojmë edhe ne, kolona të panumërta!»

Ndjeva drithma në trup. Jo vetëm nga freskia e mbrëmjes... U ngrita në këmbë dhe ju përgjegja: «Po, Lefter. Rrugën e nisur do ta vazhdojmë. E do ta çojmë gjer në fund. Natën e mirë!»

## PËRMBAJTJA

	Faqe
— Hapat e parë në jetë .....	5
— Periudha e veprimeve spontane dhe e ëndë- rimeve .....	12
— Në prak të luftës .....	29
— Universitetet e mia .....	33
— «Ora e luftës ka ra...» .....	39
— «Djali i popullit Lefteri!...» .....	78
— Biseda ime e fundit me Lefterin .....	83

52419

